



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Veriore  
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

**KABINETI I KRYETARIT**

**Nr. Prot.** \_\_\_\_\_.

**Data:** 30/01/2025

**Mitrovicë Veriore**

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KOMUNA MITROVICA E VERIUT - OPŠTINA SEVERNA MITROVICA			
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY			
Njesia Org. Org. Jedin. Org. Unit.	01	Nr. Prot. B.N. Prot. Prot. No.	01-030/01-0001193/25
Nr. Ifaqeve B.N. Stranica No. pages	71	Data Datum Date	30.01.2025

## RAPORTI I PUNËS 2024

Janar 2025, Mitrovicë Veriore

Raporti i punës paraqet te dhenat per punet e perfunduara ne vitin 2024 sipas detyrave dhe përgjegjësiwe të parapara ligjore, institucionale dhe organizative. Raporti i Punës është përpiluar ne baze te Planit te punës zhvilluar në bazë të prioriteteve qeverisëse dhe kërkesave të qytetarëve.

## **DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTËR DHE GJEODEZI**

Lëndë të përfunduara gjatë periudhës raportuese:

### **Kadastër dhe Gjeodezi**

Incizim / regjistrim i ndërtesës	28	Regjistrim i ndalesës	5
Regjistrim i pronës	49	Regjistrim i urdhërit të Gjykatës	2
Regjistrim i lokalit	13	Regjistrim i urdhërit përmbartimor	1
Korrigjim i të dhënave	46	Bartje pronësie	179
Pëlqim dhe Raport për Policinë	12	Certifikata të pronësisë	730
Ndarje / bashkim të parcelave	24	Kopje plani	321
Regjistrim të barrës tatimore	9	Vërtetim pronësie	274
Lirim nga barra tatimore	4	Koordinata	153
Fshirje e hipotekës	10	Regjistrim hipoteke	3

### **Urbanizëm**

Leje për shfrytëzim të hapësirave publike

11

## DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Me mbështetjen e Ministrisë së punëve të brendshme të cilët na e kanë ofruar placin afër stacionit të autobusëve, ku tashmë ka ndërtesë e cila është në ndërtim si edhe me ndihmën e Ministrisë së Drejtësisë Komuna e Mitrovicës së Veriut dhe Ministria e drejtësisë dhe ajo e punëve të brendshme kanë nënshkruar një memorandum mbështetjeje për hapjen e Strehimores.

Projekti për Strehimore do të jetë sipas Konventës së Stambollit së bashku me mbështetjen e EULEX-it, Objekti do të mbrohet sipas rregulloreve me gardh të lartë dhe mbikëqyrje speciale të lidhur me Policinë.

Është formuar një ekip për për zhvillimin e Strehimores, zyrtarja policore nga Zyra për viktimat dhunë në familje Teuta Maliqi, Teuta Kastrati për barazi gjinore, avokati Burhan Maxhuni, Maria Mišković nga Agjencia për ndihmë juridike dhe Zëvendësja e Kryetarit të komunës Katarina Adjančić.

Duke qenë se kemi numër të madh të viktimave të dhunës në familje në Komunën e Mitrovicës së Veriut, është mbajtur një takim me Drejtoreshën e policisë Zylfije Dema nga Dhunë në familje dhe mbrojtjen e monument të bashku me praninë e grave nga OJQ -të.

U propozua hapja e linjës SOS për ndihmë viktimave.

Në Qendër kontaktohen edhe prindërit në kushte të kontrolluara me fëmijë të mitur që sipas padisë nuk i përkisnin prindit tjetër dhe në periudhën e sipërpërmendur kemi pasur 20 raste të tilla.

Në bashkëpunim me policinë kemi pasur gjithsej 35 raste të raportuara të Dhunës në familje.

Gjithsej 5 familje i kemi vendosur në Strehimore në pjesën jugore të Mitrovicës për periudhën e përmendur deri në zbutjen e marrëdhënies të prishura familjare.

Për shkak të marrëdhënies të dëmtuara rëndë bashkëshortore ku ishte e pamundur pajtimi i bashkëshortëve, kemi pasur 37 divorce ku ndërmjetësuam për interesin më të mirë të fëmijëve të mitur.

Sipas raportit të policisë kemi pasur edhe 12 raste të delikucencës së të miturve.

Fëmijët me aftësi të kufizuara të lindura kanë pasur në tre raste një komision për ushtrimin e të drejtave të tyre, ku nga gjithsej njëmbëdhjetë fëmijë, pesë kanë arritur të drejtën e ndihmës sociale.

Sa i përket përfituesve të ndihmës sociale, numri i tyre varionte nga muaji në muaj kështu që në janar dhe shkurt kemi pasur gjithsej 488 përfitues, në mars 485, në prill 436, në maj 424 dhe në qershor gjithsej 427, korrik 417, gusht 405, shtator 401, tetor 373, nëntor 381 dhe dhjetor 346 përfitues të ndihmës sociale.

Që nga maji, nga ana e Ministrise perkatese jemi përfshirë në të ashtuquajturat Pilot projekti SAS, i cili i referohet mundësisë së përdoruesve për të aplikuar në mënyrë elektronike përmes platformës e-kosova, ku pas aplikimit, qendra përfshihet duke dalë në terren dhe duke përcaktuar besueshmërinë e të dhënave të ofruara nga palët gjatë aplikimit. Gjithashtu, që nga muaji shtator qendra ka rinovuar dokumentacionin për familjet që përfitojnë ndihmë për fëmijë dhe më pas kemi marrë një njoftim se për shkak të ngarkesës së shtuar, qendrat janë liruar nga ky detyrim, në mënyrë që familjet me fëmijë të mitur të aplikojnë për shtesë postës së Kosovës.

Sa i përket Shëndetësisë, për shkak të gjendjes aktuale në Mitrovicën Veriore, nuk kemi juridiksion në Institucionet shëndetësore, dhe as bashkëpunimi me autoritetet sepse ata refuzojnë çdo komunikim të mundshëm si edhe sugjerimet për ndihmë.

Punëtorët të cilët ishin të punësuar në shëndetësi, nëntë prej tyre, nuk janë lajmëruar në punë. Nuk kisha kurrfarë qasje në vijueshmërinë e tyre në punë. Kam inicuar disiplinore procedurë.

Është formuar Komisioni me rastin e fillimit të procedurës disiplinore për shkeljen e detyrimeve dhe përgjegjësisive të zyrtarëve publike, d.m.th zyrtarëve të kujdesit shëndetësor parësor dhe dytësor në komunën Mitrovicë e Veriut.

Anëtarët komisionet janë : Lirije Fejza, Aida Sejdiu, Hamit Mripa.

Një nga planet ka qenë edhe hapja e një ambulante dhe patronazhi për ndihmë të gjithëve të cilët jetojnë në Veri, në Lagjen e Boshnjakëve.

Kam kontaktuar me banorët lokal dhe kam prezantuar këtë plan, shumica kanë qenë dakord me këtë ide sepse kanë nevojë për të secilën ndihmë të mundur të kujdesit shëndetësor.

Po ashtu, është mbajtur një takim me Ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitija, i cili është pajtuar me këtë ide dhe ka rënë dakord që ky projekt të realizohet në periudhën në vijim.

Inspeksioni sanitar ka vizituar ordinancat private në Mitrovicën e Veriut, dhe më pas, disa mjekë kërkuan takim me Zëvendësen Katarina, në takim u tha se duhet të punojnë sipas rregullores dhe kushteve që sociala ordinancë duhet ti plotësoj . Njëri nga problemet e paraqitura ka qenë problemi i licencës së Kosovës.

Pas kësaj jam takuar me Ministrin e Shëndetësisë dhe kam prezantuar këtë problem , i cili do të realizohet në periudhën në vijim.

Krahas këtyre detyrave që kam si Drejtoreshë e shëndetësisë dhe çështjeve sociale, e konsideroj si detyrë t'i ndihmoj të gjithë banorët, pa dallim kombësie dhe feje.

Në çdo moment jame gatshme ti dëgjoj qytetarët për ankesat dhe problemet që kanë dhe t'ju ofroj ndihmë.

Kam vizituar disa familje të cilat janë të gjendje të rëndë sociale, që jetojnë në kushte joadekuate. Ata nuk janë shfrytëzues të ndihmës sociale. Pas kësaj vizite kam njoftuar Qendrën për punë sociale për t'i ndihmuar këta qytetarë.

Me mbështetjen e Kryetarit kemi ndihmuar pacientët me sëmundje të rëndë onkologjike. Një pjesë e buxhetit të paguar ishte për të gjithë të sëmurët që kishin nevojë për ndihmë.

Gjatë vitit 2024 kam ndjekur seminare të organizuara nga organizatat e NDI-së, si dhe organizatat e tjera joqeveritare, për të edukuar veten dhe përmirësuar veten në përmirësimin e drejtorisë që drejtoj.

Pjesëmarrja në takimet në Prishtinë për çështje shëndetësore dhe sociale. Një nga takimet ishte edhe programi i banimit adekuat social në Kosovë, i cili do të zbatohet në periudhën e ardhshme.

## DREJTORIA PER SIGURI DHE EMERGJENCA

Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë në kuadër të drejtorisë për Shërbime Publike nga data 15 tetor në viti 2024 ka filluar së funksionalizuar, Bazuar në ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera Nr.04/L-027, Ligjin për Mbrojtjen nga Zjarri Nr.04/L-012 ,Ligjin për Zjarrfikje dhe Shpëtim Nr.04/L-049 si dhe rregulloret Komunale .

Gjatë kësaj periudhe kohore në kuadër të Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë kemi pasur gjithësej 22 raste të kërkesave të natyrave të ndryshme të cilat janë të adresuar në zyrën tonë.

Gjithashtu në Drejtorin për Shërbime Publike, kemi adresuar disa shqetësimet cilat janë vlerësuar si mundësi të rrezikut nga faktorët e ndryshëm, faktori njeri, faktori klimatik dhe rreziqet tjera.

Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar vizita të rregullta në teren për evidentimin e rreziqeve potenciale për banorët e Komunës së Mitrovicës Veriore .

Vizita bashkëpunimi me Komandantin Zjarrfikëseve të Komunës Mitrovicës Veriore, kemi pasur bashkëpunim me organet e rendit për situata të ndryshme në raste emergjente ,si dhe bashkëpunim me Agjensionin për Menagjim e Emergjencave ku gjate takimin me ta kanë shprehur gatishmërinë për bashkëpunim ndër institucional.

Gjithashtu kemi dhanë rekomandime për qytetarët e Komunës përmes zyrës së informimit pasi mbretëronte moti me era të forta.

Si zyrtar për Siguri dhe Emergjencave kemi vijuar trajnime të cilat kanë qenë të mirë se ardhura për përmisimin e përfomancës dhe ngritjen e kapaciteteve si Zyre për Siguri , dhe Emergjencave.

Gjatë muajit Tetor kemi pasur vizita zyrtare në teren që kanë pasur për qëllim ofrimin e Siguris për banorët dhe komunitetin si dhe takimet me organet e Siguris Policin e Kosovës për të vlersuar gjendjen e Siguris në Komunën e Mitrovicës Veriore .

Në muajin Nëntorë kemi pasur intervenim në Kodren e Minatorve për arsyeje të rrëshqitjes të dheut, ku në bashkëpunim me Inspektorët Komunal , Policin e Kosovës , Zjarrefiksat dhe Agjensionin për Menagjim të Emergjencave kemi marrur të gjitha masat e duhura për parandalimin e qarkullimit dhe evitimit të rreziku për qytetarët .



Gjatë muajit Nëntorë pas kërkesës së bërë në Drejtorin për Shërbime publike kemi pasur bashkëpunim për pastrimin e pjesës anësore të rrugës nga shkurret dhe mbetjet inerte në drejtim të fshatit Suhodoll.



Rruga Koloshinska ne drejtim te urës kryesore

Në muajin Nëntorë në Kuadër të Drejtoris për Siguri dhe Emergjencia gjatë këti muaji për shkak të gjendjes Emergjente që ka mbretëruar në Kosovë në bashkëpunim me Drejtorin e Sherbimeve publike kemi bërë furnizimin me ujë të pishem për banorët e Komunës së Mitrovicës Veriore si dhe Spitalit Regjional në jug të Mitrovicës pas kërkesës së bërë.



Lagja e Boshnjakeve





Spitali Regjional Mitrovicës Jugore

Gjatë muajit dhjetor të vitit 2024 kemi pasur intervenime me Zjarrfiksat me asistim të Inspektorve Komunal për prerjen e disa drunjëve që paraqesin rrezik për banorët në rrugën Kral Petar .



Rruga Kral Petar, Komuna e Mitrovicës Veriore

Gjatë vitit kalendarik 2024 Shërbimi i Zjarrfikëseve të Komunës së Mitrovicës Veriore ka pasur gjithsej 192 raste të intervenimit.

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int.tjera janar-dhjetor 2024

2024	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar			Të vdekur			Githsejt
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot	
Janar	16	6	9	0	1	0	0	2	2	0	0	0	16	
Shkurt	30	19	11	0	0	0	0	0	0	0	0	0	30	
Mars	25	14	9	0	0	0	2	0	0	0	1	1	25	
Prill	10	10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	10	
Maj	9	1	7	1	0	0	0	0	0	0	0	0	9	
Qershor	13	8	3	1	0	0	1	0	0	0	0	0	13	
Korrik	16	6	7	2	1	0	0	0	0	0	0	0	16	
Gusht	20	12	7	1	0	0	0	0	0	0	0	0	20	
Shtator	13	9	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	13	
Tetor	11	3	8	0	0	0	0	0	0	0	0	0	11	
Nëntor	15	7	8	0	0	0	0	0	0	0	0	0	15	
Dhjetor	14	7	6	0	1	0	0	0	0	0	0	0	14	
Gjithsejtë	192	102	79	5	3	0	3	0	2	2	0	1	192	



## DREJTORIA PËR KOMUNITETE LOKALE DHE KTHIM

Demografia e komuniteteve jo shumicë në komunën e Mitrovicës Veriore, nuk dihet saktë pasi që regjistrimi i fundit i popullësisë në vitin 2011, në qytetin e Mitrovicës Veriore nuk është realizuar fare. Andaj të dhënat tona i bazojmë në raportet e organizatave ndërkombëtare sic është ai i OSCE "Municipal Profiles" në vitin 2018. Sipas të cilit në komunën e Mitrovicës Veriore banojnë 29,460 banorë. Sipas përbërjes etnike në komunën e Mitrovicës Veriore, banojnë 22.530 Sërb, 4900 Shqiptar, 1000 Boshnjak, 580 Goran, 210 Turk, 200 Rom, 40 Ashkali. Drejtoria për Komunitet Lokale dhe Kthim, ka përfshirje ndëretnike ngase stafi i saj përbëhet nga Egjiptian, Sërbë dhe Boshnjak. Drejtoria gjithashtu realizon takime periodike me përfaqësues të komuniteteve që jetojnë në Komunë nëse paraqitet ndonjë problem dhe përpiqet t'i ndihmojë ata. Në rastet kur drejtoria nuk mund të ndihmojë, ne i drejtohem Shërbimeve të ndryshme Komunale për ndihmë (në varësi të problemit), ose i referojmë njerëzit në OJQ të ndryshme ose organizata ndërkombëtare që mund të ofrojnë ndihmën e duhur. Gjithashtu, ne koordinohemi me institucionet shtetërore, ministri të ndryshme, Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policinë e Kosovës etj. në mënyrë që të arrihet zgjidhja më e mirë dhe të zgjidhen problemet e komuniteteve në mënyrën më të mirë të mundshme.

### **Kthimi:**

- Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda vendit dhe shtete të regjionit Serbi, Mal të Zi, Maqedoni
- Procesi për regjistrimin e personave-familjeve në kuadër të aktiviteteve për riintegrimin e personave të riadhesuar
- Të ndryshme: trajnime, seminare, vizita të OJQ-ve vendore dhe ndërkombtare
- Kthimi i qëndrueshëm i personave të zhvendosur brenda vendit dhe shtete të regjionit Serbi, Mal të Zi, Maqedoni

Sa i përket kthimit të qëndrueshëm të personave të zhvendosur (periudha ,viti 1998/99 dhe 2004) brenda vendit dhe shtete të regjionit, kryesisht Serbi, Male të Zi dhe Maqedonin Veriore hynë në kuadër të detyrave dhe obligimeve primare të drejtorisë komunale për komunitete dhe kthim nuk ka pasur kërkesa për kthim.

Pjesa më e madhe e komuniteteve romë, ashkalijë, janë të kthyer në pronat e tyre në Jug të qytetit gjatë viteve 2007-2010, të cilëve u janë ndërtuar shtëpitë me ndihmën e Komunës së Jugut ,përmes alokimit të tokës (mbi 10 hektar toke) dhe mbeshtetje financiare të organizatave ndërkombëtare .Në 3 mujin e parë 2024, nuk kemi pasur të kthyer në mënyrë të organizuar apo përmes ndonjë organizate vendore apo ndërkombëtare. Mu për këtë fakt edhe nuk kemi të dhëna e as ndonjë kërkesë për kthim të komuniteteve të lartcekura e të cilat kërkesa, sidomos të komuniteteve romë, ashkalijë, egjiptian , personave të zhvendosur në shtete të regjionit sidomos nga Mali i Zi dhe Serbi.

Mund të ketë ndonjë rast, kthim spontan të paorganizuar i komuniteteve Romë, Ashkalijë, e të cilët nuk lajmërohen tek ne zyre për evidentim, ndërsa numri i të kthyerve të komunitetit shqiptar në pjesën veriore, në këtë periudhë raportuese është i vogël.

### **Regjistrimi i rasteve ,riintegrimi i personave të riadhesuar**

Edhe gjatë periudhës Janar-Qershor 2024 në këtë periudhë kohore nuk ka pasur të kthyer nga shtete Europiane , andaj edhe me pake raste, kërkesa të paraqitura në zyret tona. Në departamentin për kthim dhe riadhesim në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, kemi kërkuar akses në sistemin e menagjimit të rasteve. Gjithashtu jemi në pritje të ftesës së mbajtjes së trajnimit të zyrtarëve të drejtorisë rreth funksionimit të sistemit të menagjimit të rasteve. Komisioni Komunal për Ri-integrim/KKR/ gjatë periudhës kohore Janar- Mars, për shkak të mungesës së personelit adekuat, e

profesional nuk është krijuar. Në aspektin e pergaditjes sa me të mirë dhe me profesionale në drejtim të realizimit sa më me sukses të Strategjisë për ri-integrimin e personave të riatdhesuar dhe Rregullores në fuqi, gjerë më tani jemi në pritje për të mbajtur disa trajnime dhe disa takime në nivelin qendror perkatesisht në MPB- Departamenti e riatdhesimit.

#### - Të Ndryshme

Ne kete periudhe Janar- Qershor 2024 kemi pasure aktivitete te ndryshme me OJQ-te vendore apo nderkombetare, trajnime dhe punetori te organizuara. Brengje te madhe paraqet buxheti shume i vogel i ndare per drejtorine tone apo me mire te themi se ky buxhet nuk mbulon ase nevojat elementare per disa raste, kur kesaj i shtohen edhe rastet e riatdhesimit sidomos per rastet pase kalimit te njevjeqarit per akomodim te personave te riatdhesuar e qe Komunen e obligon edhe Ligji për Veteqeverisje lokale dhe Ligji mbi financimin e veqant te banimit qe ketyre personave te cilet nuk kane ku te banojne tu ndihmohet me pagese te qirase.

Projektet - në terren për komunitetet dhe përfituesit e tyre dhe bashkëpunimi me palët e interesuara - aktivitete për ndërgjegjësimin e publikut:

-Në periudhën Janar- Dhjetor 2024, Drejtoria Komunale për Komunitete dhe Kthim ka mbajtur disa takime krahas kryerjes së detyrave aktuale, të cilat janë pjesë përbërëse e punës së zyrës, të gjitha me qëllim të përmbushjes së detyrave që janë obligim i drejtorisë.

- Gjatë muajit Janar, asistuaam pjestarë të komuniteteve jo shumicë për të aplikuar në thirrjen publike të MAPL-së për ndërtimin e shtëpive. Gjithashtu realizuam vizita për të informuar rreth kësaj thirrje publike, për rezultatet e të cilës jemi në pritje. Ndërsa nga thirrje publike e kaluar janë 7 pjestarë të komuniteteve jo shumicë.

-Në muajin janar patëm një takim me zyrtarët e Drejtorisë në të cilin është bërë Finalizimi i planit te punes 2024.

- Nga drejtori dhe stafi i Drejtorisë janë realizuar Takime me pjestarë të komunitetit Rom dhe komuniteteve të tjera.

- Vizita ne teren per thirrjen e hapur te MAPL se bashku me keshilltaret e Ministrit.

-Pjesemarrja ne panelin “Dialogu nderetnik dhe kohezioni social, fuqizimi i grave, pakicave dhe te rinjeve per pajtim ne Kosove.

- Vizita ne teren tek familjet e komunitetit Boshnjak ( janë realizuar 42 vizita në teren, ku janë marrë të dhënat demografike në mënyrë që si drejtori të kemi listat tona me të dhëna)

- Pjesemarrja ne eventin permbylles te projektit “ Ofrimi i sherbimeve pavaresuese per personat me aftesi te kufizuara dhe pjestareve te komuniteteve jo shumice”.

- Organizimi i sesionit per grate e komuniteteve jo shumice me temen “ Barazia Gjinore dhe mos diskriminimi në bashkëpunim me zyrën për barazi gjinore.

- Pjesemarrja ne kampin verore “ HARMONY TALKS” te organizuar nga organizata ADRC ne partneritet me organizatën joqeveritare REC, te financuar nga UNDP dhe Bashkimi Evropian. Me kete rast te rinje dhe te reja kishin mundesine qe te shkembejne pervoja, te socializohen me njeri tjetrin dhe ne fund te dalin me disa ide qe do te financohen nga REC dhe ADRC. Realizimi i disa aktiviteve rinore do te perfshijë edhe qytetin e Mitrovicës Veriore.

-Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) në Kosovë, Qendra Rajonale në Mitrovicë organizoi punëtorinë "Trajnim për përfaqësuesit e komuniteteve fetare dhe anëtarët e këshillave komunale të sigurisë për parandalimin e incidenteve të sigurisë", ku morën pjesë punonjësit e Drejtorisë.

-Në këtë periudhë janë mbajtur disa mbledhje të Komitetit për Komunitete, por drejtorja jonë nuk është ftuar të marrë pjesë në këto takime, për të bashkëpunuar apo raportuar.

- Propozim për formimin e grupit punues për hartimin e PLANI I VEPRIMIT PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI 2023-2027

- Pjesëmarrja në eventin e projektit “Harmony Talks”

- Pjesëmarrja në fokusgrup nga organizata SIT

- Debati me studentet nga komunitete të ndryshme në regjionin e Mitrovicës

- Takim me organizatën “ Mitrovica Women Association For Human Rights”

- Promovimi i mbështetjes së arsimit të komuniteteve në pakice numerike organizua nga OSCE

- Tri takime të grupit punues për hartimin e Planit të veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali 2024-2026

- Draf Planit i Veprimit për Avancimin e të drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali 2024-2026

- Takim me UNHCR dhe Advancing Together për situatën e komuniteteve dhe riadhesimin

- Takim pune me Jennifer Bell, Grese Lamallari, Visar Ymeri, Andreas Katsouris për të diskutuar për gjendjen e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Mitrovicë.

- Pritja e paleve në zyrë dhe keshilli për çështje të ndryshme

- Takime dhe vizita në teren për të diskutuar me qytetarë sa i përket të drejtave dhe lirive themelore dhe mosdiskriminimit

- Shpërndarja e veshmbathjeve për femijet e komuniteteve Rom dhe Ashkali në bashkëpunim me Kryqin e Kuq.

- Pjesëmarrja në tryeza dhe panele nga organizatat e shoqërisë civile

- Takim pune në mes të ekzekutivit të komunës dhe Kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Albin Kurti dhe ministrave Elbert Krasniqi dhe Nenad Rashic.

- Pjesëmarrja në tryezën e përbashkët në mes të Kryeministrit Albin Kurti dhe ZKKK-të nga të gjitha komunat e Kosovës

- Pjesëmarrja në kampin vjeshtor me të rinjtë e komuniteteve nga rajoni i Mitrovicës me temën menagjimi i konflikteve.

- Asistimi i palëve për aplikime në thirrjet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

- Pjesëmarrja në aktivitetet kulturo artistike

- Shpërndarja e dhuratave për festat e fundvitit në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

### **Planifikimi dhe buxhetimi i zyrës**

Para planifikimit të buxhetit për vitin 2024, nga drejtorja e financave na janë dhënë udhëzime sipas të cilave duhet të planifikojmë buxhetin, dhe i njëjti është planifikuar dhe miratuar. Sipas buxhetit për vitin 2024, për DKKK-në janë paraparë 500 euro nga mjetet për mallra dhe shërbime. Në tremujorin e parë të vitit aktual janë zhvilluar shumë vizita në teren. Në zyrën pritëse kanë marrë mjaftueshëm kërkesa për ndarjen e pakove ushqimore dhe higjienike për familjet në gjendje jo të mirë financiare.

Pas një vizite në terren dhe shqyrtimit të dokumentacionit të bashkëngjitur kërkesave kemi përzgjedhur familjet përfituese të ndarjes së ndihmave. Shpërndarja ende nuk është kryer për shkak se nuk është kompletuar ende dokumentacioni i plotë i tenderit nga shërbimi i prokurimit, kështu që pakot do t'u shpërndahen familjeve në tremujorin e dytë të këtij viti. Sfide tjeter momentale mbetet mungesa e stafit në drejtori, ngase tash e një muaj e gjysme kemi mbetur pa zyrtarët perkates.

### **Çështje ose aktivitete të tjera**

Një nga problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohet drejtorja është mungesa e stafit sa i përket departamentit për komunitete lokale dhe kthim. Përveç kësaj, shpesh herë kemi takime me OJQ-të, Policinë e Kosovës, FSK-në etj., pastaj punojmë edhe me palë etj. dhe nevojitet një numër më i madh i zyrave. Çdo qytetar i komunitetit joshumicë që i drejtohet njëres prej drejtorive për ndihmë, zakonisht së pari do të drejtohet tek ne për të zgjidhur problemin e tij, gjë që është e pamundur, sepse secila Drejtori Komunale ka një fushë specifike të punës me të cilën merret.

Pavarësisht këtyre kushteve të punës Drejtorja jonë përpiqet të përmbushë detyrat e saj të punës dhe të ndihmojë në mënyrën më të mirë komunitetet vulnerabël, pavarësisht vështirësive me të cilat përballlet.

## DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

- Shërbimet në zyrën e Gjendjes Civile
- Sektori Financave
- Kërkesat
- Kërkesat për rekrutim
- Sektori I IT-s
- Shërbimet Teknike

### Shërbimet në Departamentin e Gjendjes Civile

Departamenti i Gjendjes Civile ka operuar me staff të kompletuar , duke kryer kështu çdo ditë shërbime për qytetarët e Komunës së Mitrovicës Veriut.

Kemi raportuar edhe në Raportin paraprak që e kemi planifikuar për sektorin e Gjendjes Civile të rekrutohet staff për shkak të nevojave të këtij Sektori.

Në fillim të vitit që shkoj, saktësisht, me datën 17.01.2024 kemi shpallur pozitat si në vijim:

- Zyrtar i Gjendjes Civile – dy pozita
- Zyrtar për Arkiv në zyrën e Gjendjes Civile – një pozitë

Tani, Departamenti i Gjendjes Civile funksionon me gjithsej tre staff.

Sipas Raportit të marrë nga Intraneti për periudhën e Vitit Janar – Dhjetor 2024 kemi këto të dhëna:

### Numri i lëndëve për shenja të klasifikimit sipas departamenteve Drejtoria DAP

Shenja	Shenja DSC	Numri
030/01	Ne pergjithesi per punen ne zyre	164
030/02	Aktet qe kane te bejne me pajisjet, lokalet e punes dhe orendite, kompjuteret e punes dhe mjetet tjera ndihmese	3
052/01	Pergjithesisht per statistiken dhe raportimin	6
200/01	Gjendja Civile dhe Evidencat	9.188
200/02	Ne pergjithesi per lindjet dhe evidencat per lindje	1
200/03	Librat ame te lindjes, evidencat dhe duplikate	1
201/01	Emrat mbiemrat dhe nr personal	55
202/01	Ne pergjithesi per kurorizimet dhe evidencat e ndryshme per kete çeshtje	153
203/01	Vdekjet ne pergjithesi	23
400/01	Sistemet financiare buxhetore	1
410/02	Bleresi – furnizuesi, faturat, dokumentet percjellese, evidencat e furnizimit dhe raportet per furnizim	164
431/01	Ne pergjithesi per tatimet nga bizneset	1
431/03	Aktet administrative per percaktimin e obligimit tatimor	1
431/04	Te hyrat nga gjoba	274
434/01	Taksat ne pergjithesi	18
470/06	Raportet periodike	1

### 10.054

Ndërsa, të dhënat për periudhën e vitit 2024 për numrin e kërkesave për certifikata të GJC sipas zyrtarit shqyrtues janë si më poshtë:

Enis.Djekovic

Pershkrimi

Certifikata e vendbanimit

Miratuar

39

Refuzuar

0

Totali

39

Certifikata e lindjes	48	0	48
Deklarata e bashkësisë familjare	54	0	54
Certifikata e vdekjes	28	0	28
Certifikata e statusit martesor	28	0	28
Certifikata e Marteses	28	0	28
Certifikata e Shtetësisë	8	0	8
Ekstrakti i Lindjes	639	0	639
	<b>872</b>	<b>0</b>	<b>872</b>

#### Lejla Atiq

Pershkrimi	Miratuar	Refuzuar	Totali
Certifikata e vendbanimit	35	0	35
Certifikata e lindjes	63	0	63
Deklarata e bashkësisë familjare	67	0	67
Certifikata e vdekjes	38	0	38
Certifikata e statusit martesor	47	0	47
Certifikata e Marteses	37	0	37
Certifikata e Shtetësisë	3	0	3
Ekstrakti i Lindjes	809	0	809
	<b>1099</b>	<b>0</b>	<b>10998</b>

#### Fatime Stavileci

Pershkrimi	Miratuar	Refuzuar	Totali
Certifikata e vendbanimit	190	0	190
Certifikata e lindjes	614	0	614
Deklarata e bashkësisë familjare	680	0	680
Certifikata e vdekjes	273	0	273
Certifikata e statusit martesor	193	0	193
Certifikata e Marteses	234	0	234
Certifikata e Shtetësisë	22	0	22
Ekstrakti i Lindjes	5900	0	5900
Vertetim nga Arkiva	5	0	5
	<b>8111</b>	<b>0</b>	<b>8111</b>

#### Fatime Stavileci

Shenja	Pershkrimi	Numri
200/01	Gjendja Civile dhe Evidencat	7.302
200/02	Ne pergjithesi per lindjet dhe evidencat per lindje	1
200/03	Librat ame te lindjes evidencat dhe dublikate	1
201/01	Emrat mbiemrat dhe numrat personal	55
202/01	Ne pergjithesi per kurorizimet dhe evidencat e ndryshme per kete çeshtje	101
203/01	Vdekjet ne pergjithesi	23
431/01	Ne pergjithesi per tatimet nga bizneset	1
431/04	Te hyrat nga gjobat	221

7.705

#### Myrvete Ramaxhiku

Shenja Pershkrimi



200/01	Gjendja Civile dhe Evidencat	2	2
--------	------------------------------	---	---

#### Enis.Djekovic

##### Shenja Pershkrimi

200/01	Gjendja Civile dhe Evidencat	830
202/01	Ne pergjithesi per kurorizimet dhe evidencat e ndryshme per kete çeshtje	21
431/04	Te hyrat nga gjobat	16

**867**

Zyra për Shërbime me Qytetarë, funksion në baza të rregullta ditore, për çdo shërbim që kërkohet nga qytetarët e Komunës së Mitrovicës Veriore.

Kjo zyrë operon me gjithsej tre staff , ku secili zyrtar i ka të ndara Drejtorit.

Sipas Raportit, numri i lëndëve për shenja të klasifikimit sipas zyrtarit regjistruar janë si vijojnë:

#### Arlinda.Wohlessner

##### Shenja Pershkrimi

030/01	Ne pergjithesi per punen ne zyre	160
030/02	Aktet qe kane te bejne me pajisjet, lokalet e punes dhe orendite, kompjuteret e punes dhe mjetet tjera ndihmese	3
052/01	Pergjithesisht per statistiken dhe raportimin	6
200/01	Gjendja Civile dhe Evidencat	5
400/01	Sistemet financiare buxhetore	1
410/02	Bleresi – furnizuesi, faturat, dokumentet percjellese, evidencat e furnizimit dhe raportet per furnizim	164
434/01	Taksat ne pergjithesi	17
470/06	Raportet periodike	1

#### Laura Lushta

##### Shenja Pershkrimi

030/01	Ne pergjithesi per punen ne zyre	160
200/01	Gjendja Civile dhe evidencat	2
434/01	Taksat ne pergjithesi	1

#### Departamenti i Financave / Pagesat

Edhe gjatë vitit të kaluar kemi pasur bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Financave. ku kemi procesuar kërkesa për pagesa nga kategoritë e caktuara, ku për secilën faturë kemi bërë kërkesën për pagesa dhe raportin e pranimit.

Poashtu, kemi dorëzuar në muajin Gusht edhe Planifikimin Analitik të Buxhetit si dhe Planifikimin e Projekteve Kapitale 2025-2027.

Këtu, kemi planifikuar **"Digjitalizimin e Arkivës në Administratën Komunale"** në Komunën e Mitrovicës Veriore me nr identifikues **647-24-9074-2-2-1**.

Kjo procedurë është inicuar përmes prokurimit, me titull të projektit **"Digjitalizimi I Arkivës në Administratën Komunale"** me Kod Buxhetor **163380** dhe me nr të projektit **54910**, ku vlera e planifikuar për këtë procedurë ka qenë **70.000 Euro**.

Kemi pranuar poashtu edhe kërkesën për Zotim të mjeteve financiare.

Për këtë projekt kapital, kemi marr vendim për caktimin e menagjerit të kontratës si dhe mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menagjerit të kontratës i cili e ka fituar tenderin për punimet në Arkiv. Kompania e cila e ka fituar është **DOCMAN SH.P.K ; Art House SH.P.K**. Magjistrale Prishtinë – Shkup Menagjeri i kontratës është caktuar Asdren Peci, dhe mbikqyrës Blerta Abrashi. Të gjitha punimet kanë shkuar sipas marrëveshjes së kontratës, ku me datën **20.11.2024** është pranuar fatura me nr **0218/24** në vlerë prej **30.000 Euro**, këtu bashkëngjitur kemi pranuar poashtu, edhe Situacionin e parë të punimeve në Arkiv si dhe Raportin e Ekipit Menagjues. Me datën **20.12.2024** kemi pranuar faturën me nr **0245/24** në vlerë prej **39.455.00 Euro** dhe situacionin e dytë të punimeve ku i gjithë ky projekt ka përfunduar me gjithsej dy situacione. Tani Arkiva e Administratës Komunale është funksionale dhe operon me një staff.

Projekti i dytë kapital të cilën e kemi planifikuar në Planin Buxhetor është projekti me titull **“Rregullimi i hapësirës dhe digjitalizimi I qendrës për shërbime të qytetarëve në Administratën Komunale”** me nr identifikues **647-24-9924-5-2-1/C347** me kod buxhetor **163380** dhe me nr të projektit **54970** ku vlera e planifikuar për këtë projekt është **200.000 Euro**. Ky projekt është paraparë të përfundohet brenda vitit 2024 saktësisht me datën 10.12.2024 nga Kompania **“Tosi – V” SH.P.K Pejë**.

Tek ky projekt menagjer kontratës kemi caktuar Aida Sejdiun, si dhe mbikqyrës të drejtpërdrejt është caktuar Blerta Abrashi.

Me datën **25.11.2024** kemi pranuar faturën me nr **89/24** në vlerë prej **20.000 Euro**, ku këtu pagesa është bërë në bazë të situacionit të parë të pranuar. Krahas kësaj kemi pranuar edhe Raportin e Ekipit Menagjues.

Me datën **10.12.2024** kemi pranuar faturën me nr **101/2024** në vlerë prej **60.000 Euro** pagesa është bërë në bazë të situacionit të dytë. poashtu edhe Raportin e Ekipit Menagjues.

Dhe, me datën 19.12.2024 kemi pranuar faturën me nr **137/2024** në vlerë prej **104.161.50 Euro**, pagesa është bërë në bazë të situacionit të tretë, duhet të përfshijmë këtu edhe pranimin e Certifikatës së pranimit të përkohshëm.

Pra, ky projekt është paraparë të përfundoj me gjithsej katër situacione , mirëpo ka përfunduar me tre situacione.

Poashtu kërkesë nga Departamentii Financave kemi pasur Listën dhe Afatet për regjistrim të Zotimeve për vitin 2024. Drejtoria Administratës ka përgatitur të gjitha Zotimet dhe I ka dorëzuar në Departamentin e Financave.

#### **Kontratat e publike kornizë të realizuara**

Kontratat publike Kornizë i kemi ende aktive. Në këtë vit kemi kontrata që do skadojnë, dhe ne do të fillojmë të rishikojmë paramasat për këto kontrata, dhe do të vazhdojmë me procedurat e rregullta, siç kemi vepruar edhe në vitin paraprak.

#### **Vendimet e marra për Vitin paraprak**

Në vitin që lëmë pas kam pranuar Vendimin nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore Z. Erden Atiq Vendim për themelimin e Komitetit Koordinues në Komunën e Mitrovicës Veriore për Zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Qeverisje të Hapur 2023–2025.

Komiteti Koordinues është me këtë përbërje:

- 1.1 Blerta Shala Abrashi – Kryesuese
- 1.2 Ylber Gjoshë – Zyra Ligjore
- 1.3 Irfan Mehmeti – Anëtar Zyra për Informim
- 1.4 Adren Peci – Anëtar IT
- 1.5 Elbrus Sejdiu – Zyrtar për Rini dhe Sport

Ky komitet do të ketë për qëllim përgjegjësinë së bashku me MAPL-n për përmbushjen e katër zotimeve nga Plani Kombëtar i Veprimit si në vijim :

Qeverisje Digjitale , Të dhënat e hapura , Pjesëmarrja Qytetare , Kundër – Korrupsioni.

Vendimi i dytë i marr është Vendimi për Thjeshtëzimin e Shërbimeve në Komunën e Mitrovicës Veriore.

Ky Vendim ka për qëllim thjeshtimin e shërbimeve të cilat ofrohen nga Drejtorit përkatëse të Komunës së Mitrovicës Veriore. Ky vendim ka hyrë në fuqi me datën 01.2025.

Dhe Vendimi i tretë i marr për vitin paraprak është Vendimi për formimin e Komisionit për evidentimin e pasurisë jo financiare të inventarit të Komunës së Mitrovicës Veriore.

Komisioni është i përberë nga: Aida Sejdiu – Kryesuese, Asdren Peci – Anëtar dhe Myrvete Ramaxhiku – Anëtare.

Evidentimi i pasurisë do të filloj javën që vjen me datën 20.01.2025.

### **Kërkesat e Realizuara për Rekrutim**

Duke parë nevojën për funksionalizim më të mirë të Institucionit të Komunës së Mitrovicës Veriore vitin që leme pas kemi bere kerkesa per rekrutim ne keto departamente:

- Me datën 22.08.2024 – kemi shpallur pozitën për Një udhëheqës I Sektorit të IT-s
- Me datën 09.12.2024 – kemi shpallur pozitën për Një Auditor të Brendshëm dhe një Zyrtar për Shërbime me Qytetar
- Me datën 16.12.2024 - kemi shpallur pozitën për një Vozitës

Tani nga këto pozita kemi të përfunduar vetëm pozitën e Udhëheqësit të IT-s.

Të tjerat pozita i kemi ende në procedurë.

### **Kërkesat të tjera**

Si drejtori e Administratës kemi kërkuar bërë kërkesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme për Veturat Zyrtare që duhen të pajisen me “ Leje Parkim”. Kërkesa është realizuar me datën 18.10.2024 për këto Vetura :

- Nissan Pathfinder me targa 02Z-22-38 – Vetura e Kryetarit
- Nissan Pathfinder me targa 02Z -23-38
- Skoda Oktavia me targa 02Z-17-38

Kjo procedurë ka përfunduar me sukses.

Poashtu dje me datën 16.01.2025 kemi realizuar një kërkesë për lejimin e Transferimit për nëpunësën civile Samra Krama nga zyrtare / referente në DUKGJ, në Asistente Administrative në Zyrën për Informim.

## DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Ky raport vjetor përmbledh aktivitetet dhe arritjet e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport gjatë vitit 2024 duke theksuar zhvillimet kryesore dhe përpjekjet tona për përmirësimin e kushteve dhe mundësive për kulturë, rini dhe sport në nivelin lokal. Jeta kulturore/sportive në këtë pjesë të qytetit është e mangët për shkak të mungesës së infrastrukturës sportive/kulturore, objektivi ynë gjatë kësaj periudhe ka qenë krijimi i mundësive dhe infrastrukturës për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive për të gjithë grupet e shoqërisë.

### **AKTIVITETET KULTURORE/SPORTIVE**

Gjatë vitit 2024 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka mbështetur eventin e organizuar me rastin e ditëlindjes së poetit dhe artistit Kadri Kadriu, event ky i cili është mbajtur në Korrik/2024.

Muajin gusht/2024, kemi marrë pjesë në Edicionin e 14 të Green Festivalit në Mitrovicë, festival ky i cili synon të angazhojë të rinjtë dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre në çështjet e mbrojtjes së ambientit.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhë morrëm pjesë në Festivalin “Mitrovica Guitar Days” ku performuan artist të njohur botëror.

Në dhjetor/2024 në Galerinë “Kadri Kadriu” u mbajt koncerti dedikuar promovimit të trashëgimisë sonë të pasur kulturore përmes muzikës të bukur shqipe. Ky event u organizua nga organizata joqeveritare “Kosovaars” dhe u mbështet edhe nga drejtoria jonë.

Me kërkesën e prindit Veton Vidishi , kërkesë kjo e cila kërkoi mbështetje financiare për dy (2) fëmijët e tij, sportist në sportin e tenisit, drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ndau 2000.00 Euro.

Pas punimit dhe dorëzimit të projektit tonë “Fushë Basketboli” në lagjen tre (3) Rrokaqiejt. Meridian Express ka bërë një donacion në vlerë prej 1000.00 Euro. Fusha u përfundua sipas afatit të parashikuar në projekt dhe u përrurua në tetor të vitit 2024.

Së bashku me inspektorët, ekipën e Departamentit për Kulturë, Rini dhe Sport kemi identifikuar fushën sportive aktuale (tek MTS) dhe problematikat rreth saj. Nevoja për ristrukturimin e saj ishte e pashmangshme. Infrastruktura e saj është e vjeturuar, me mungesë ndriqimi dhe ulëseve në hapsirat e parashikuara për to. Punuam dhe dorëzuam projektin “Fitarena” tek banka Procredit, atyre u pëlqeu idea, aprovuan projektin tonë dhe në mars të 2025-tës pritet të fillohen punimet.

Pas një vizite që gjatë këtij viti bëmë në shkollat e veriut, ndër të tjera, kishte mungesë të topave për sportet që zhvillohen në kuadër të lëndës edukatë fizike, bëmë një kërkesë të cilën e dorëzuam në Interex, kërkesa u aprovua dhe me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor 2024/2025, shkollat u paisën me topa për basketboll, futboll dhe volejball.

Në kuadër të fushatës ndërgjegjësuere për parandalimin e trafikimit me njerëz, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në bashkëpunim me drejtorët dhe mësimdhënësit e shkollave fillore, organizoi një aktivitet edukativ për nxënësit. Ky aktivitet kishte për qëllim informimin e fëmijëve mbi rreziqet dhe mënyrat e mbrojtjes nga ky fenomen i dëmshëm. U punua dhe u dorëzua në MAPL raporti i vijueshmërisë së pjesëmarrësve në këtë ligjëratë.

Pasi që pranuar ftesën nga organizata jo qeveritare “Let’s Do It Kosova”, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi aktivitetin për të bërë pastrimin e zonave të lëna pas dore, për të shënuar 20 Shtatorin, Ditën Botërore të Pastrimit. Në këtë iniciativë i pranishëm ishte edhe Krytari Atiq.

Në muajin korrik/2024, së bashku me krytarin morrëmpjesë në kryerjen e homazhit në nderim të të jetës dhe veprës së Ismail Kadare në Tiranë.

Verë në Dimër, aktivitet ky i cili u organizua për herë të parë në Komunën Veriorese bashku me shefin e kabinetit, ftuam në takim Asim Azemin, diskutuam se çfarë mund të bëjmë bashk për nder të festave

të fundvitit, u dakorduar që të vendosim 4 shtëpiza dhe të organizojmë (gjatë ditës) aktivitete me performanca muzikore. Ne si komunë kemi mbështetur financiarisht dhe kemi qenë bashkëpjesëmarrës në shumicën e aktiviteteve që u mbajtën javët e fundit të 2024-tës.

Është bërë kërkesa për dhënjen e dhuratave për rastin e Vitit të Ri, është dorëzuar dhe 200 dhurata janë dhënë nga ETC dhe 100 nga Komuna jonë dhe kemi bërë shpërndarjen e tyre në shkollat e veriut.

#### **TAKIMET GJATË VITIT 2024**

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2024 është angazhuar maksimalisht në realizimin e detyrave të cilat janë të ngarkuara për këta sektor. Pas pranimit të detyrës, gjatë kësaj periudhe (me kërkesën e kryetarit) identifikuar dhe organizuar takime me disa organizata joqeveritare në Mitrovicë dhe Prishtinë.

Ndër takimet e para, ishte takimi me Znj. Drita Kadriu- Drejtore për Arsim. Bashkë me kryetarin Z. Erden Atiq, kërkuam nga Drejtorja të dhënat e përditësuara për numrin e nxënësve të Veriut e që vijojnë mësimet në Jug. Pas takimit, Drejtorja e Arsimit në Komunën e Jugut dërguan listat dhe jemi duke u angazhuar për projektet e planifikuara me shkollat e Veriut.

Ndër prioritetet tona këtë vit ishte ishte (dhe vazhdon të mbetet akoma) identifikimi i Organizatave joqeveritare në Komunën Veriore dhe shikimi i mundësive për bashkëpunim. Në mënyrë formale (në disa raste edhe joformale) u takuam me disa prej tyre. Ndër organizatat që takuam : organizata joqeveritare "Inspiracija" udhëhequr nga znj. Ljilijana Drazević, organizata DOMOVIK përfaqësuar nga z. Nenad Radivojević, organizata ACTIVE me përfaqësues z. Miodrag Milicević si dhe një takim patëm edhe drejtorën e AQUARIUS znj. Miliana Bullatović. Të gjitha nga organizatat e lartpërmendura u falënderuan për interesimin që patëm për t'i takuar dhe u shprehën të gatshme për bashkëpunim gjatë vitit 2025.

Ndër planifikimet tona për këtë periudhë ishte edhe skanimit i tereneve (fushave sportive qofshin ato në lagje apo shkolla, hapsirave të ndryshme publike) të cilat kanë nevojë për ristrukturim. Bashkë me stafin vizituam shkollat fillore të Komunës Veriore, identifikuar problemet dhe nevojat e tyre. Bëmë foto në fusha të vogla sportive të cilat ishin duke u shfrytëzuar për parking dhe shikuam mundësitë e rivitalizimit të tyre.

Në zyrën e Kryetarit pritëm Znj. Fitore Pacolli dhe diskutuam në lidhje me Politikën e Gjelbra, ndërmarrjen e iniciativave mjedisore për të rritur mirëqenien e qytetarëve.

Takim tjetër i rëndësishëm ishte edhe takimi me Sekretarin e Përgjithshëm të MKRS-së Z. Xheladin Krasniqi dhe Z. Mujë Igrishta- Bashkëpunor profesional Arkeologji-Histori. Qëllimi i takimit ishte diskutimi në lidhje me Shtëpinë Muze. Përfaqësuesit na udhëzuan të skenojmë edhe njëherë gjendjen, të mbledhim dokumentet e nevojshme të cilat na rekomanduan dhe të vazhdojmë procedurat për futjen e Shtëpisë Muze në listën e Trashëgimisë Kulturore. Intervenimi tek Përmendorja, Palestra Sportive dhe Kulla e Kadri Kadriut ishte gjithashtu pjesë e bisedave tona. Pas kompletimit dhe dorëzimit të dokumentacionit (sa i përket çështjes së Shtëpisë Muze), faza e parë ka kaluar.

Një tjetër takim ishte edhe takimi me Ipko Foundation, përfaqësuese Znj. Vlora Shabiu. Së bashku me Vlorën biseduam rreth një projekti që ata janë duke e implementuar në disa komuna "Empower Her", dhe shprehën interesim të bashkëpunojnë edhe me komunën tonë. Kërkesa e tyre ishte që ne si komunë të bëjmë zgjidhje për transport të vajzave të cilat janë të interesuara për ndjekjen e trajnimit.

Këtë periudhë vizituam edhe kompani private, banka dhe organizata të tjera jo qeveritare, ndër to: Meridian Express, Interex, Pro Credit Bank, NLB. Pranë tyre shpalosëm planet tona, pranuar këshilla se çfarë mund të bëjmë bashkë, si mund të na mbështesin dhe të realizojmë projektet tona. Nga këto kompani, Interex, Pro Credit Bank, dhe Meridian shprehën gatishmëri për t'u përgjigjur karshi kërkesave tona.



Bashk me kryetarin Z.Erden Atiq, pritëm në zyret tona Z.Muhedin Nushi- Këshilltar i Lart- Këshilltar i Lartë Politik, Merita Fejza- Mësimdhënëse në Shkollën “Nonda Bulka”, Qefsere Mripa- Mësimdhënëse në Shkollën “Nonda Bulka”, dhe Lumturie Beqiri- përfqësuese nga Këshilli i Prindërve. Në takim diskutuam mbi ndërtimin e një shkolle në Komunën Veriore. Përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit u shpreh i gatshëm për investim duke na theksuar se mjetete janë të ndara. Javën e parë të Tetorit do të mbajmë edhe takimin e dytë për të diskutuar më detaisht.

U takuam po ashtu edhe me znj.Afërdita Sylja, udhëhqese e CBM, diskutuam për mundësitë se çfarë aktivitete mund të bëjmë bashk.

Në Organizatën REC u takuam me z.Uka, na priti në zyret e tij, u shpreh mirënjohës për organizimin e takimit dhe ( i është përgjigjur kërkesës tonë për dërgimin e listës së organizatave joqeveritare të cilat operojnë në jug e veri).

Në vazhdën e takimeve është edhe ai me Shoqatën e Kosovës për Tekstil, përkatësisht Drejtorën Ekzekutive Znj.Merita Sylja me të cilën diskutuam për bashkëpunime mes organizatave në Veri dhe Shoqatës së Tekstilit në vitin 2025.

FES- Friedrich Ebert, CBM, REC- Reconciliation Empowering Communities, Yonus Emre janë organizata që kemi takuar gjatë kësaj kohe për t’u njohur dhe të shikojmë çfarë mund të bëjmë bashk.

Ndër takime të tjera, vlen të theksohet takimi me Kforin Turk. Pesë (5) përfaqësues të tyre pritëm në zyrat tona. Kohë më parë dorëzuam edhe tek ta disa projekte të cilat i diskutuam gjërësisht zyret tona. Projekti që u bëri përshtypje më shumë ishte ristrukturimi i fushës tek MTS. Ata dorëzuan në Ankara projektin që u bëri përshtypje më shumë, na lajmëruan se është aprovuar, nuk vazhduam procedurat meqenëse ProCredit Bank veç se na kishte dhënë përgjigje pozitive për këtë fushë.

Takim tjetër me rëndësi është edhe ai me organizatën qeveritare TIKA përkatësisht me Z.Blerim Karabaxhaku. Në takim diskutuam për mundësitë e bashkëpunimit, para TIKA-së shpalosëm projektet tona. Ata u shprehën të gatshëm për mbajtjen edhe të një takimi tjetër, na udhëzuan për procesin e aplikimit për projekte.

Në zyrat tona pritëm edhe artistin Mehmet Preteni i cili kërkoi mbështetje për një projekt teatror të titulluar “Waiting for Train”, meqenëse isht pothuajse fundi i vitit nuk patëm mundësi për mbështetje në këtë projekt, biseduam dhe ramë dakord që të punojmë bashk një projekt (shfaqje teatrale për fëmijë) gjatë vitit 2025.

Në muajin dhjetor/2024 u nënshkrua marrëveshja (për mbështetjen e ristrukturimit të fushës tek MTS) me Bankën Procredit, njëherit u mbajt edhe sesion informues nga Banka në lidhje me ofertat e fundit që ata ofrojnë.

Konaktuam dhe u dakorduam për takim me Organizatën Joqeveritare Swiss Contact, pritëm në zyret tona znj.Teuta Hoxha dhe z.Lulzim Krasniqi, diskutuam për mundësitë e bashkëpunimit, para nesh Swiss Contact shpalosi projektet e tyre dhe na rekomanduan (nëse si komunë jemi të gatshëm) që bashkarisht të ndërmarrim hapat e parë për të punuar në lidhje me krijimin e strategjisë së turizmit.

Këtë vit po ashtu edhe përfaqësues nga Kryqi i Kuq shprehen interesim për takim, bashk me kryetarin takuam në zyret tona dhe i njoftuam për së afërmi rreth çështjeve që ata shprehën interes ( edukimin, ekonominë, mënyrën e jetë së njerëzve në veri, komunën, sfidat dhe planet).

Takim tjetër i rëndësishëm brenda kësaj periudhe një vjeçare ishte edhe ai me znj. Ejona Icka- Drejtore Ekzekutive në Organizatën Ndërkombëtare Joqeveritare YSP BALKAN( Youth and Students For Peace). Bashk diskutuam rreth fuqizimit të rinisë në të gjitha komunitetet dhe forcimin e bashkëpunimit për të nxitur unitetin dhe përparimin.

Takim tjetër patëm edhe me përfaqësuesit e organizatës joqeveritare CDF z.Oltion Beshiri dhe znj.Valëza Zogiani. Diskutuam për bashkëpunim në lidhje me realizimin e një aktiviteti të planifikuar me ndërmarrësit nga

rajoni, drejtoria jonë punuam në përpilimin e listës së një grupi ndërmarrësve (afro 25 biznese) dhe dërguam tek CDF.

Bashkë me kryetarin z.Atiç, pritëm në zyret tona përfaqësuesit nga Fondi i Kosovës për Efiqencë të Energjisë. Bashkë diskutuam për bashkëpunimet e mundshme, na njoftuan detaisht për punën që e kanë bërë dhe po bëjnë me komunat tjera dhe na udhëzuan për hapat që duhet të marrim për fillimin e mbledhjes të dhënave të nevojshme për të filluar bashkëpunimin.

Është themeluar Instituti për Krimet e Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë. Së bashku me kryetarin pritëm në zyret tona z.Atdhe Hetemi-Drejtor Ekzekutiv në këtë Institut, kërkesa e tij ishte mbledhja e të dhënave (informatave, fakteve ) të krimeve të luftës. U nënshkrua edhe marrëveshja e bashkëpunimit mes Komunes dhe Institutit (nga kryetari Atiq dhe drejtorit të Institutit).

Në vazhden e takimeve, takim me rëndësi ishte edhe takimi me z.Luan Cabra, President në Federatën e Parabocia të Kosovës. z.Luan na njoftoi se kjo Federatë merret me organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive që lidhen me parabocën, një sport popullor në disa rajone të Kosovës. Ajo ka për qëllim promovimin e këtij sporti, organizimin e kampionateve dhe ngjarjeve sportive, si dhe mbështetje për zhvillimin e infrastrukturës dhe rregullave të nevojshme për këtë disiplinë. Ky sport luhet nga personat me aftësi të kufizuara dhe me z.Cabra diskutuam se çfarë mund të bëjmë bashk, ai erdhi me kërkesë për mbështetje dhe do ta shqyrtojmë në vitin 2025.

Po ashtu takim përfaqësuesit të llojit(dhe kërkesës së njejtë) patëm edhe me z.Avni Kelmendi, kryetar i parafederatës së paraatletikës. z.Avni kërkoi mbështetje për blerjen e disa pasisjeve sportive për këtë sport i cili po ashtu luhet nga persona me aftësi të kufizuara dhe mbështetje për pjesëmarrje në turnire botërore.

Takim i rëndësishëm gjatë këtij viti ishte edhe ai me Ambasadorin e Austrisë z.Georg Schnetzer, ai desh të informohej me të gjitha sfidat dhe planet që kemi si komunë e që kryetari e njoftoi për gjendjen aktuale, sfidat e të kaluarës dhe planet. Ai u shpreh i gatshëm për të na ofruar mbështetje në vitin 2025 (meqenëse takimi u mbajt pothuajse në fund të vitit).

Në zyret tona, bashk me kryetarin pritëm përfaqësuesit e KFOR-it, ku u diskutua për situatën aktuale dhe sfidat kryesore që po përballemi. Fokusimi i takimit ishte në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit, si dhe në projektet për zhvillimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët tanë.

Pas takimit që kishim me Kompaninë Interex dhe shpalesjes së disa projekteve të punuara nga Drejtoria jonë (për përgjigjen e të cilave jemi akoma në pritje) Interex pasi u njoftua për së afërmi se sa shkolla janë në veri, cilat janë nevojat dhe kërkesat e tyre, ata ndanë një donacion për tre (3) shkollat tona. Donacioni ishte në vlerë prej 336.00 Euro dhe u nda për nder të fillimi të vitit shkollor 2024-2025. Ky donacion përfshiu topa futboll, basketbolli, volejboli, pako me ngjyra, lapsa dhe çanta. Bashkë me kolegët kemi bërë shpërndarjen në shkolla.

“Fego” është projekt i Helvetas dhe u dakorduam që së bashku të vizitojmë atelen e z.Ljilina (me të cilën ishim takuar më herët) dhe të diskutojmë se në çfarë forme mund të bashkëpunojmë.

Gjithashtu, si drejtori jemi angazhuar edhe në mbledhjen e donacioneve për rregullimi e sheshit për rastin e fundvitit.

### ***PJESËMARRJE NË TAKIMET (TRYEZA)***

Ndër të tjera, organizata më e madhe jo qevitare “ACTIVE” në veri na ftoi të marrim pjesë në një diskutim të hapur me temë “Lufta kundër korrupsionit dhe transparenca” të udhëhequr nga Yll Buleshkaq- Drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit. Aty takuam edhe drejtorë të organizatave tjera, krijuam kontakte të reja dhe u dakorduam për takime të mundshme.

Një tryezë (takim koordinues) të cilën e organizoi CBM, në të cilën ishin të ftuar Drejtoritë Komunale për Kulturë, Rini dhe Sport, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile si dhe qendrave rinore nga rajoni i Mitrovicës,

morrëm pjesë dhe ne si Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport. Gjatë takimi shpalosëm aktivitetet e planifikuara si dhe biseduam për mundësitë e bashkëpunimit. Qëllimi kryesor i takimit ishte ofrimi i alternativave të cilat ndihmojnë në zbutjen e faktorëve që shpien tek radikalizmi.

Së bashku me drejtorët e drejtorive tjera, gjatë këtij viti kemi marrë pjesë në punëtorin e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Në këtë punëtori u trajtuan tema për rritjen e partneritetit mes palëve me interes përbrenda qeverisjes lokale, forcimin e komunikimit të brendshëm, obligimet legjislative etj.

#### **OBLIGIMET BRENDA INSTITUCIONIT**

Gjatë kësaj kohe na është kërkuar nga Drejtoria e Financave Planifikimi i Projekteve Kapitale dhe Qarkorja e Brendshme Buxhetore e cila u punua dhe u dorëzua brenda periudhës kohore të planifikuar.

Bashkë me stafin e drejtorisë tonë u punua në përmirësimin dhe gjetjen e datave për kalendarin e aktiviteteve për vitin 2025.

Po ashtu brenda kësaj periudhe u punua edhe raporti me rastin e marrjes së donacionit nga kompania Interex dhe Meridian Express.

#### **ARSIM**

Kosova Makers League organizon çdo vit gara në fushën e robotikës, drejtoria jonë kontaktoi shkollat, i njoftoi për procesin e aplikimit dhe në baza javore kontaktoi me Kosova Makers dhe shkollat e interesuara për pjesëmarrje në këto gara.

Kemi kontaktuar me drejtorët e shkollave të Komunës Veriore të Mitrovicës dhe kemi marrë të dhënat e fundit të numrit të nxënësve (sipas moshës, gjinisë).

<b>Shkolla Fillore “Nonda Bulka”</b>	<b>Shkolla Fillore “Aziz Sylejmani”</b>
Numri i Nxënësve	Numri i Nxënësve
<b>198</b> Nxënës	<b>211</b> Nxënës
<b>85 F</b>	<b>187 F</b>
<b>113 M</b>	<b>102 M</b>

<b>Aziz Sylejmani- Suhodoll</b>	<b>Aziz Sylejmani- Ismail Qemail</b>	<b>Aziz Sylejmani- Kodër</b>
<b>101</b> Nxënës	<b>93</b> Nxënës	<b>17</b> Nxënës
<b>56 F</b>	<b>46 F</b>	<b>7 F</b>
<b>45 M</b>	<b>47 M</b>	<b>10 M</b>

Totali

**409** Nxënës

#### **MARRËVESHJET E NËNSHKRUARA NË KUADËR TË DREJTORISË**

<b>Marrëveshja me kompaninë Meridian Express</b>
<b>Marrëveshja me ProCredit Bank</b>
<b>Marrëveshja me Kompaninë e Sigurimeve “Eurosig”</b>
<b>Marrëveshja me YSP-Balkan</b>

## DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE INFRASTRUKTURË

Duke u bazuar në kërkesën për Raportin e punës për vitin 2024, DSHPIIE gjegjësisht sektori për Infrastrukturë Rrugore në vazhdim do të cekim punën e realizuar për vitin 2024.

Fillimisht pas takimeve me Drejtorin e DSHPIIE-së kemi pranuar detyrat dhe kemi vazhduar me pregaditjen e punimeve për realizimin e punëve të parapara sipas planit të shpenzimeve për vitin 2024. Sipas planit të shpenzimeve Drejtoria e DSHPIIE-së, ka shfrytëzuar kontratën për Hartimin e Projekteve, ku pas takimeve me Kryetarin, Drejtorin dhe Shefin e Kabinetit kemi pranuar urdhëresën për realizimin e projekteve sipas planit të shpenzimeve për vitin 2024, ku kemi bërë fletë porosinë për hartimin e projekteve për t'u mundësuar realizimi i tyre.

Në këtë periudhë është bërë hartimi i këtyre projekteve:

- Rrugët në lagjën Kodra e Minatorëve - "Millan shuflai ( Vlade Cetkovic) dhe Aksi 1 majtas"(projekti i rrugës, kanalizimit fekal dhe atmosferik).
- Rruga në Lagjën Bergjani "Aksi kryesor dhe Aksi 1 - rruga e Zveqanit" (projekti i rrugës, kanalizimit fekal dhe atmosferik).
- Rrugët në "Lagja Kroi I Vitakut - rrugët në zonën Kadastrale Suhodill i Epërm aksi 1, 2, 3 dhe 4.
- Rugët tek Tre Rrokaqiejt "Degëzimi i parë majtas i rrugës Kolaashini nga rruga Aleksa Shantiqa në drejtim të Urës kryesore" (projekti i rrugës, kanalizimi fekal dhe atmosferik).
- Rugët tek Tre Rrokaqiejt "Degëzimi i parë majtas i rrugës Kolaashini nga rruga Aleksa Shantiqa në drejtim të Urës kryesore" (projekti i ndriqimit publik).
- Rruga "Vinogradska" (projekti i rrugës).
- Rruga "Vinogradska" (projekti i ndriqimit publik).
- Rregullimi – Sanimin e rrugës "Mbreti Petër" (projekti i rrugës).
- Rregullimin – Ndërtimin e rrugës "Mbreti Petër" AKSI 1 (projekti i rrugës).
- Rregullimi – Sanimin e rrugës "Vojvode Bojovic" (projekti i rrugës).
- Rregullimin – Ndërtimin e rrugës "LUJ BRAJ" (projekti i rrugës).
- Asfaltimin dhe rregullimin e rrugëve në Lagjën e Boshnjakëve Aksi 11 dhe 14, ndërtim (projekti i rrugës).
- Asfaltimin dhe rregullimin e rrugëve në Lagjën e Boshnjakëve Aksi 1, Aksi 2, Aksi 3, Aksi 4, Aksi 5, Aksi 6, Aksi 7, Aksi 8, Aksi 9, Aksi 10, Aksi 12 DHE Aksi 13 " - Sanim (projekti i rrugës).
- Asfaltimin dhe rregullimin e rrugëve në Lagjën e Boshnjakëve Aksi 10 (projekti i murit).

- Rregullimi i hapësirës dhe digjitalizimi I qendrës për shërbime të qytetarëve në Administratën Komunale.

Gjithashtu në këtë vit duke u bazuar në kërkesën e Kryetarit të Komunës është bërë hartimi i disa projekteve të cilat nuk kanë qenë në planin e shpenzimit për vitin 2024, mirëpo pas takimeve në Ministrinë, ku i është premtuar Kryetarit të Komunës nga MAPL-ja dhe MPB-ja se do të financojnë këto projekte është bërë edhe hartimi i projekteve si në vijim:

- Ndërtimi i parkut me fusha sportive në anën e majtë të rrugës Kollashini (përballë 3 Rrokaqiejëve).
- Ndërtimi i parkut afër objektit të Komunës së Mitrovicës Veriore në rrugën Çlirimi.
- Ndërtimi dhe rregullimi i shetitorës përgjatë lumit Ibër nga Ura Kryesore deri tek Ura Lindore, me infrastrukturë përcjellëse..
- Ndërtimi i Murit Mbrojtës në lagjën “Anke Spajiq”.

Gjithashtu në këtë periudhë kemi inicuar procedurat për projektet e parapara sipas planit të shpenzimeve për vitin 2024 dhe për shumicën e këtyre projekteve është lidhur kontrata me Operatorë Ekonomik. Në këtë periudhë janë inicuar procedurat për projektet dhe janë përfunduar punimet në projektet si në vijim:

- Ndërtimi dhe Asfaltimi i rrugës Boro Stanković në Komunën e Mitrovicës Veriore – Është nënshkruar kontrata dhe është filluar me punime.
- Rregullimi i Rrugës Mbreti Peter, Rruga Vojvode Bojovic dhe Rruga Luj Braj – Vlera e Projektit 208,101.13 € - ku është përfunduar projekti.
- Asfaltimi dhe rregullimi i rrugëve në Lagjen e Bashnjakeve – Vlera e Projektit 217,945.21 € - ku është përfunduar projekti.
- Asfaltimi dhe rregullimi i rrugëve dhe rrugicave në qytet (Lagjia Kodra e Minatoreve, Bergjan, Kroi i Vitakeve dhe tek Tre Rrokaqiet - Memorandum Mirëkuptimit për financimin e projekteve Infrastrukturore në mes Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapsinorë dhe Infrastrukturës – Vlera e Projektit 740,750.19 € - ku projekti vazhdon të realizohet (projekt tre vjeçarë).

Ndërsa në këtë periudhë në koordinim me Drejtorin dhe Shefin e Kabinetit të Kryetarit kemi filluar me pregaditjen për iniciimin e procedurave për disa projekte të cilat nuk ishin të parapara, mirëpo duke marrë parasysh nevojën e madhe për arsye se deri më tani nuk ka pas Komuna kontratë për ofrimin e këtyre shërbimeve publike. Kemi filluar me pregaditjen dhe është lidhur kontrata për projektet si në vijim:

- Debllokimi, Pastrimi dhe sanimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik për nevojat e Komunës së Mitrovicës Veriore – Vlera e Projektit 40,000.00 € - kontrata kornizë tre



vjeqare ku punimet janë në realizim e sipër (ku në vitin2024 është bërë pagesa në vlerë prej 4,998.80 €).

- Mirembajtja dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik për nevojat e Komunës së Mitrovicës Veriore – Vlera e Projektit 100,000.00 € - komtrata kornizë tre vjeqare ku punimet janë në realizim e sipër (ku në vitin2024 është bërë pagesa në vlerë prej 11,500.00 €).
- Shenjzimi horizontal dhe vertikal në qytet për nevojat e Komunës së Mitrovicës Veriore – Vlera e Projektit 120,000.00 € - komtrata kornizë tre vjeqare ku punimet janë në realizim e sipër (ku në vitin2024 është bërë pagesa në vlerë prej 12,747.69 €).

Ndërsa në këtë periudhë në koordinim me Drejtorin dhe Shefin e Kabinetit të Kryetarit kemi filluar me pregaditjen për iniciimin e procedurave për projektet si në vijim, mirëpo nuk kemi arritur të lidhim kontratë ku për arsye të ofertave të pa përgjegjshme është bërë anulimi i këtyre aktiviteteve:

- Rrënimi, Bartja, Magazinimi i Materialeve, Mallrave dhe Objekteve si dhe Hudhja në Deponi te Materialeve dhe Mallrave te Sekuestruara - Konfiskuara për nevojat e Komunës së Mitrovicës Veriore.
- Rregullimi, riparimi dhe asfaltimi i rrugëve në Qytet për nevojat e Komunës së Mitrovicës Veriore.

Gjatë kësaj periudhe gjithashtu kemi marr pjesë në disa trajnime si dhe kemi punuar si anëtarë në komisione ku jemi të emëruar nga Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore.

## ZYRA E PROKURIMIT

Raporti vjetor i Zyrës së Prokurimit të Komunës së Mitrovicës Veriore ofron një pasqyrë të procesit të prokurimit për vitin 2024. Ky dokument synon të paraqesë një analizë të hollësishme të aktiviteteve të prokurimit, përfshirë procedurat e realizuara, sfidat e hasura, dhe rezultatet e arritura në përputhje me rregullat dhe standardet e prokurimit publik. Raporti gjithashtu përmban rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të procesit për vitin që vjen.

Prokurimi publik është një komponent kyç i administratës publike, i cili siguron që fondet e shtetit dhe të administratës vendore të përdoren në mënyrë efikase dhe në interes të mirëqenies së qytetarëve. Ky raport vjetor synon të ofrojë një pasqyrë të proceseve të prokurimit të realizuara nga Zyra e Prokurimit në Komunën e Mitrovicës së Veriut, duke e analizuar atë në kontekstin e parimeve dhe standarteve të prokurimit publik.

Aktiviteti i prokurimit i realizuar është bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë, nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejshëm LPP). Përveq LPP-së, aktiviteti i punës së Zyrës së Prokurimit Publik është i bazuar edhe në Rregulloren e Prokurimit Publik, Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik si aktet detyësore të aprovuara dhe shpallura nga Bordi i KRPP-së.

Duke u bazuar në dokumentet e lartëcekura, Zyra e Prokurimit Publik e komunës së Mitrovicës së Veriut gjatë aktivitetit të saj të punës ka pasur për bazë dhe synim gjithnjë përmbushjen dhe respektimin e parimeve bazë të dispozitave të LPP-së, sikurse janë: parimi i ekonomicitetit (**vlerës për paranë**), barazisë në trajtim/jo diskriminim, efikasitetit, transparencës etj. Duke zbatuar këto parime, është synuar që, në të gjitha aktivitetet e prokurimit të realizuara nga Zyra e Prokurimit Publik të sigurohet që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën sa më ekonomike, sa më efikase, më transparente dhe më të drejtë, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, poashtu që fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion, sipas një kontrate publike, të mundë të përdoren nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës, duke respektuar me përpikëri barazinë në trajtim/ jo diskriminimin e Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit.

Në periudhën raportuese, Zyra e Prokurimit Publik, konform dispozitave ligjore që rregullojnë lëmin e prokurimit publik, ka iniciuar dhe realizuar **gjithsej 23 projekte gjatë vitit 2024**, një ANKESE në OSHP ku lënda është rikthyer në Rivlërim dhe është në pritje për nënshkrim të Kontratës në janar 2025, një procedurë e negociuar pa publikim të Njoftimit për Kontratë (punë shtesë 10% e vlerës së parashikuar) e për të vazhduar më tej realizimin dhe përmbushjen e kërkesave për gjitha shtyllat e buxhetit të Autoritetit Kontraktues respektivisht për gjitha Njësitë Kërkuese, si vijon:

1. Administratës së Përgjithshme Komunale
2. Njësia e Zjarrëfiksëve
3. Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë Inspektion dhe situata Emergjente
4. Arsimit duke përfshirë shkollat fillore dhe të Mesme

## 5. Shëndetësi

Në bazë të nenit 33 deri 37 të LPP-së Autoriteti Kontraktues mundë që gjatë ushtrimit të një aktiviteti të prokurimit dhe varësisht nga natyra – lënda dhe vlera parallogaritare e prokurimit, të shfrytëzojë njëri nga procedurat, si vijon:

1. Procedurë e hapur;
2. Procedurë e kufizuar;
3. Procedura konkurrues me negociata;
4. Procedura e negociuar pa publikimin e Njoftimit për Kontratë;
5. Procedurë e kuotimit të çmimeve; dhe
6. Procedurë për kontratat me vlerë minimale

Poashtu në bazë të nenit 38 të LLP janë zbatuar edhe Kontrata Publike Kornizë e të cilat mund të gjinden në tabelat vijuese.

Vlen të theksohet se prej shtatorit 2023 deri në Qershor të vitit 2024 me marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Podujevës, iniciimi dhe realizimi e projekteve të Prokurimit është bërë nga Zyra e Prokurimit Publik të Podujevës.

E krejt kjo për shkak të statusit (mungesës së stafit) të Komunës së Mitrovicës së Veriut.

Dhe gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024, Zyra e Prokurimit Publik ka pasur për synim t'i përmbushë gjitha kërkesat përkatësisht t'i procedoi dhe kontrakttoi të gjitha Kërkesat e iniciuara nga Njësitë kërkuese të A.K. respektivisht projektet e parashikuara me Planifikimin përfundimtarë të aprovuar nga organet kompetente të Komunës.

Ky raport përmbledh aktivitetet dhe rezultate të procesit të prokurimit gjatë vitit 2024, duke paraqitur informacion mbi procedurat, tenderët e zhvilluar, dhe vlerësimin e menaxhimit të prokurimit në nivel komunal. Objektivi i këtij raporti është të sigurojë transparencë dhe përgjegjësi në menaxhimin e fondeve publike dhe të nxisë përmirësimin e mëtejshëm të procesit të prokurimit në të ardhmen.

## 2. Përgjegjësitë dhe Rregulloret e Prokurimit

Komuna e Mitrovicës Veriore është e obliguar të zbatojë ligjin për prokurimin public Nr.04/L-042, i cili siguron se procesi i prokurimit është i hapur, konkurrues dhe në përputhje me normat ligjore. Për këtë qëllim, Komuna ka një Zyrë të Prokurimit i cili është përgjegjës për organizimin e procedurave të prokurimit dhe përmbushjen e kërkesave ligjore.

## 3. Struktura e Prokurimit në Komunë

Në nivel komunal, proceset e prokurimit janë të organizuara dhe të menaxhuara nga:

- **Zyra e Prokurimit:** Ky departament është përgjegjës për menaxhimin e procedurave të prokurimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave të prokurimit.

- **Komisioni I vlerësimit të ofertave të Prokurimit:** Ky komision vlerëson dhe miraton ofertat për tenderët dhe siguron që proceset e prokurimit të jenë të ndershme dhe ligjore.
- **Departamenti I Financave I cili siguron mjetet financiare**
- **Njësitë e ndryshme të Komunës:** Pjesëtarët e departamenteve të tjera që përfshihen në prokurimin e shërbimeve dhe mallrave të nevojshme për aktivitete specifike.

#### 4. Misioni dhe Objektivat e Prokurimit

Misioni i Departamentit të Prokurimit është të sigurojë që proceset e prokurimit të jenë transparente, të drejta dhe efikase, dhe se përdorimi i fondeve publike të jetë në përputhje me ligjin dhe interesin publik. Objektivat kryesore për vitin 2024 kanë përfshirë:

- Sigurimin e konkurrencës së lirë dhe të hapur.
- Përmirësimin e menaxhimit të kontratave.
- Sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies.

#### 5. Sfida dhe Pengesa

Përkundër përpjekjeve për të realizuar prokurime të suksesshme, disa sfida të rëndësishme janë hasur gjatë vitit 2024:

- **Mungesa e konkurrencës:** Në disa raste, tenderët kanë dështuar për shkak të numrit të ulët të Ofertuesve,
- **Buxheti i kufizuar**
- **Situata politike në qytetin e Komunës së Mitrovicës së Veriut**

Nga ana tjetër, ka pasur disa **arritje të rëndësishme**, përfshirë përmirësimin e proceseve të menaxhimit të kontratave dhe një nivel të rritur transparence përmes përdorimit të platformave digjitale për publikimin e informacionit rreth tenderëve.

Në vijim janë llojet e kontratave të lidhura dhe të cilat ishin të planifikuara në planin e prokurimit për gjatë periudhës Janar -Dhjetor 2024 poashtu disa projekte Kornizë të iniciuara prej vitit 2022 (tre vjeqare)

Megjithatë duke zbatuar procedurë të përbashkët për disa njësi kërkuese, me theks të veçantë të Kontratave Kornizë, me qëllim të ekonomizimit dhe efikasitetit, duke pasur parasysh gjithnjë transparencën dhe trajtimin e barabartë të Operatorëve Ekonomik të interesuar, është arritur në masë të kënaqshme që procedimi i projekteve të planifikuara të realizohej në kohë dhe në mënyrë të suksesshme.

Vlen të theksohet se duke marrë parasysh të gjitha vështërsitë që i kemi tejkaluar dhe duke pasur parasysh statusin e Komunës së Mitrovicës së veriut ,mungesës së stafit dhe sfidat që është dashur ti kalojmë jemi munduar që me punë dhe përgjegjshmërinë më të lartë ti realizojmë sadopak objektivat tona si Autoritet Kontraktues.

Në perjudhën gjashtë Janar Dhetor 2024 objektivi i Autoritetit Kontraktues ka qenë që përmes një planifikimi sa më të mirëfilltë, të identifikoi në detaje të arsyeshme të gjitha kërkesat me theks të veçantë furnizimet dhe shërbimet që autoriteti kontraktues i ka parashikuar t'i prokurojë gjatë vitit fiskal 2024, në mënyrë që prokurimet e tilla të realizohen dhe sigurohen përmes zbatimit të një procedure të konsoliduar ose të përbashkët të prokurimit.

Në këtë drejtim, edhe në vitin 2024, një angazhim të theksuar ka luajtur edhe Agjencioni Qendrorë i Prokurimit ( AQP ), i cili, bazuar në kompetencat dhe përgjegjësit e tija që i ka në bazë të LPP-së, në bashkëpunim dhe me Autoritetet Kontraktuese të nivelit qendrorë dhe lokal është duke ndërmarrë aktivitetet të prokurimit të përbashkëta respektivisht të centralizuara për të lidhur kontratë të përbashkët për të përmbushur nevojat e Autoriteteve Kontraktuese, e vaqanërisht në sferën e furnizimeve dhe shërbimeve.

Aktivitetet e prokurimit dhe kontratat e lidhura nga AQP-ja e të cilat i shfrytëzon edhe Autoriteti jonë Kontraktues janë me sa vijon :

- Furnizimi me goma për automjete të A.K.
- Furnizimi me inventar për A.K.
- Furnizimi me produkte ushqimore për A.K. (bëhet fjalë për disa produkte të veçanta ushqimore si: ujë, pije, mish dhe produkte të mishit, bukë dhe produkte nga brumi, shërbime të transportit ajror, furnizim me karburant, furnizim me materiale të ndryshme zyrtare, marrja e automjeteve me Lizing - qiramarrje ndërsa AQP-ja është në procedurë për lidhjen e kontratave edhe për disa artikuj tjerë.
- Furnizimi me paisje te IT-së.

E theksojmë se edhe bashkëpunimi i ngushtë me KRPP -në dhe IKAPI-in ka luajtur rol shumë të rëndësishëm ku një prej zyrtarëve të Prokurimit është certifikuar edhe me një Certifikatë Themelore ,por prapëseprapë duke pasur parasysh se është një fushë e ndjeshme na duhet që të kemi edhe trajnime të shpeshta në fushën e prokurimit.

E ritheksojmë edhe njëherë se që të kemi një performancë edhe më të mirë na duhet të kemi bashkëpunim ,ndihmesë nga ministrinë ose donatorët në mënyrë që të kemi një bashkëfinancim në relizimin e projekteve te cilat janë më se të domosdoshme për qytetarët e Komunës së Mitrovicës së Veriut .

### **Prokurimi elektronik**

Sikurse sqaruam edhe më lartë, në pajtim me dispozitat e nenit 42 të LPP-së nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 çdo aktivitet të prokurimit , gjegjësisht ç' do njoftim që përgatitet në bazë të nenit 39 – Njoftimi Paraprak, neni 40 – Njoftimi për Kontratë dhe neni 41 – Njoftimi për Dhënie të Kontratës, duhet të ngritet për publikim vetëm në platformën elektronike të cilën e menaxhon KRPP. Operatorët Ekonomik, të interesuar për pjesëmarrje në aktivitet tona të prokurimit nuk janë të



obliguar të bëjnë kërkesë për dosje tenderi pranë A.K., ata mundën që, pasi të jenë regjistruar në platformën elektronike të KRPP-së, të shkarkojnë vet dosjen e tenderit për të cilën shprehin interesimin për pjesëmarrje.

Në vijim ju paraqesim tabelat për kontratat e nënshkruara dhe të anuluar



KONTRATA 3 VJEQARE NGA KATEGORIA MALLRA DHE SHERBIME

ADMINISTRATE		AKTIVITETET	Vlera totale per 3 vite	Vlera totale mujore
1	AOME SHPK	Mirembajtja higjienike e ndertesës	59,034.60 €	1,639.85 €
2	SCORPION SHPK	Sigurimi fizik i objektit	114,586.16 €	3,182.95 €
3	SHALA & ASSOCIATES SH.P.K.	Shtetbinet e perfaqesimit per avokature	51,839.28 €	1,439.98 €
4	PETROL COMPANY	Derivate per automjete, gjenerator dhe makineri	851,084.56 €	

INFRASTUKTURA PUBLIKE		AKTIVITETET	Menaxheret e Kontratave	Vlera totale per 3 vite	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
1	MLAZIM BALJU	Debllokimi, Pasurimi dhe sazimi i kanalizimit fokal dhe atmosferik	Enes Jukoviq	40,000.00 €	5,000.00 €	17,500.00 €	17,500.00 €	
2	GEOGROUP SHPK	Haritimi projektive	Enes Jukoviq	150,000.00 €	21,764.04 €	35,000.00 €	60,000.00 €	
3	Traffics V.A SHPK	Shtepjehimi horizontal dhe vertikal ne qytet	Enes Jukoviq	120,000.00 €	20,000.00 €	50,000.00 €	50,000.00 €	
4	X	Rrertimi, Barja, Magazini i Materialeve, Maltrave dhe Objekteve si dhe Fudhja ne Deponi te Materialeve dhe Maltrave te Sekuestruara - Konfiskuara		80,000.00 €	10,000.00 €	40,000.00 €	30,000.00 €	
5	TERMO MONTIMI SHPK	Mirembajtja dhe zgjerimi i rrjetit te ndajshimit publik		100,000.00 €	10,000.00 €	50,000.00 €	40,000.00 €	
6	X	Rregullimi, riparimi dhe asfaltimi i rrugëve ne Qytet		80,000.00 €	5,000.00 €	40,000.00 €	35,000.00 €	
7		<b>Gjebra</b>		<b>115,000.00 €</b>		<b>30,000.00 €</b>	<b>44,000.00 €</b>	<b>41,000.00 €</b>

PROJEKTE KAPITALE

NR	EMERTIMI I KONTRATIT	NR. PROKURIMIT	LLOJI I PROCEDURES	NR I KONTRATIT	DATA E NENSHKRIMIT	KOMISIONI VLERESUES	MANAXHERI	AMBIQVRESI	VLERE E PLANIFIKUAR	VLERE E NENSHKRUAR	AFATI PERMBUSHJE S
1	Rregullimi i rrugeve ne Kodren e Minatorreve, Krci i Vitikut, Bergani dhe te 3 Krokaqajt	647-24-11802-5-1-1	Vlerë e madhe komizë Punë			Enes Juković, Merita Jashanica, Elbrus Sejdiu			774,588.00 €		36 muaj
2	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Boro Stanковиç në Komunën e Mitrovicës së Verut	647-24-4840-5-2-1	Vlerë e mesme Punë	647-24-4840-5-2-1/C335	25.07.2024	Fidan Salihu, Afrim Mullaqi, Kujtim Zhania	Enes Juković	Fair Berzati	180,000.00 €	177,470.04 €	3 muaj
3	Rregullimi i Rrugës Mbreti Pjeter, Rruga Vojvode Bojović dhe Rruga Luj Braj	647-24-7786-5-2-1	Vlerë e mesme Punë	647-24-7786-5-2-1/C342	25.09.2024	Enes Juković, Merita Jashanica, Elbrus Sejdiu	Albin Keimendi	Fair Berzati	211,059.49 €	189,201.13 €	4 muaj
4	Asfaltimi dhe rregullimi i rrugeve ne Lagjen e Boshnjakëve	647-24-7949-5-2-1	Vlerë e mesme Punë	647-24-7949-5-2-1/C343	25.09.2024	Enes Juković, Merita Jashanica, Elbrus Sejdiu	Albin Keimendi	Fair Berzati	249,383.86 €	217,945.21 €	4 muaj
5	Digitalizimi i Arkivës në Administratën Komunale	647-24-9074-2-2-1	Vlerë e mesme Shërbime	647-24-9221-5-2-1/C344	08.10.2024	Enes Juković, Merita Jashanica, Elbrus Sejdiu	Asdran Poci	Bleta Shala Abrashi	70,000.00 €	69,455.00 €	3 muaj
6	Rregullimi i bapësirës dhe digitalizimi i qendres për shërbime të cyetarëve në administratën komunale	647-24-9924-5-2-1	Vlerë e mesme Punë	647-24-9924-5-2-1/C47	11.11.2024	Enes Juković, Hamit Mripa, Albin Keimendi	Aida Sejdiu	Bleta Shala Abrashi	200,000.00 €	184,161.50 €	1 muaj

**PROCEDURAT E PROKURIMIT 2024**

NR	EMERTIMI I KONTRATËS	NR. PROKURIMIT	LLOJI I PROCEDURES	DATA E NENSHKRIMIT	MENAXHERI	VLERA E PLANIFIKUAR	VLERA E NENSHKRUAR	AFATI PERMBUSHJES	STATUSI
1	Mbështjellës për lëndë për nevojat e Administratës në Komunën e Mitrovicës Veriore	647-24-2385-1-4-7	Procedurë e Vlerës Minimale	?	X	875.00 €	875.00 €	X	Kontraktuar
2	Mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit	647-24-4114-2-4-7	Procedurë e Vlerës Minimale	26.04.2024	X	999.00 €	989.50 €	X	Kontraktuar
3	Largimi i deponive të egra	647-24-4755-2-4-7	Procedurë e Vlerës Minimale	16.05.2024	X	999.00 €	988.60 €	X	Kontraktuar
4	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Boro Stankoviç në Komunën e Mitrovicës së Veriut	647-24-4840-5-2-1	Vlerë e mesme Punë	25.07.2024	Enes Jukovic	180,000.00 €	177,470.04 €	3 muaj	Kontraktuar
5	Asfaltimi dhe rregullimi i rrugeve dhe rrugicave ne qytet (Lagjia Kodra e Minatoreve, Bergjan, Kroi i Vitakeve dhe tek Tre Rokaqiet)	647-24-5528-5-1-1	Vlerë e madhe Punë	X	X	774,588.00 €	X	36 muaj	Anuluar
6	Rregullimi i Rrugës Mbreti Pjeter, Rruga Vojsvode	647-24-6613-5-2-1	Vlerë e mesme Punë	X	X	211,059.49 €	X	4 muaj	Anuluar

	Bojovic dhe Rruga Luj Braj												
7	Debllokimi. Pastroimi dhe sanimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik	647-24-6737-2-2-1	Vlerë e mesme Shërbime	X			40,000.00	X	36 muaj	Anuluar			
8	Asfaltimi dhe rregullimi i rrugëve ne Lagjen e Boshnjakeve	647-24-6893-5-2-1	Vlerë e mesme Punë	X		X	249,885.86 €	X	4 muaj	Anuluar			
9	Vendosja e Kamerave të Sigurisë në brendësi të Objektivit të Komunës	647-24-6946-2-3-6	Vlerë e ulët Shërbime	29.08.2024		Fatmire Dushi	3,000.00 €	1,484.00 €	15 ditë	Kontraktuar			
10	Servisimin dhe rregullimin e ashensorit	647-24-6977-2-4-7	Procedurë e Vlerës Minimale	25.07.2024		X	500.00 €	450.00 €	36 muaj	Kontraktuar			
11	Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në qytet	647-24-7733-5-2-1	Vlerë e mesme kornizë Shërbime	X		X	120,000.00 €	X	36 muaj	Anuluar			
12	Furnizim me pelet per nevojat e zjarëfikseve ne Komunen e Mitrovicës	647-24-7753-1-3-6	Kuotimit të Çimitit Vlerë e ulët Furnizim	29.08.2024		Branko Milentijevic	7,000.00 €	6,000.00 €	1 muaj	Kontraktuar			
13	Rregullimi i Rrugës Mbreti Pjeter. Rruga Vojvode Bojovic dhe Rruga Luj Braj	647-24-7786-5-2-1	Vlerë e mesme Punë	25.09.2024		Albin Keimendi	211,059.49 €	189,201.13 €	4 muaj	Kontraktuar			



14	Servisimi dhe pajisje me pjesë të nevojshme për funksionalizimin me kapacitet të plotë të sistemit qendror të klimave	647-24-7811-2-4-7	Procedurë e Vlerës Minimale	X	X	990.00 €	X	X	Anuluar
15	Dijitalizimi i Arkivës në Administratën Komonale	647-24-7941-2-2-1	Vlerë e mesme Shërbime	X	X	70,000.00 €	X	3 muaj	Anuluar
16	Furnizim me kompjuter Brand Name ALL in One dhe laptop dhe laptop.	647-24-7918-5-5-8	Mini-tender Furnizim	29.08.2024	Hysnije A.Mikullovci	20,000.00 €	17,044.00 €	2 muaj	Kontraktuar
17	Debllokimi, Pastrimi dhe sanimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik	647-24-7941-2-2-1	Vlerë e mesme kornizë Shërbime	10.09.2024	Enes Jukovic	40,000.00 €	40,000.00 €	36 muaj	Kontraktuar 2024-2026
18	Asfaltimi dhe rregullimi i rrugëve në Lagjen e Boshnjakeve	647-24-7949-5-2-1	Vlerë e mesme Punë	25.09.2024	Albin Keimendi	249,885.86 €	217,945.21 €	4 muaj	Kontraktuar
19	Furnizim me Frigorifer për nevojat e zyrtarëve	647-24-7982-1-4-7	Procedurë e Vlerës Minimale	06.08.2024	X	390.00 €	390.00 €	X	Kontraktuar
20	Servisimi dhe pajisje me pjesë të nevojshme për funksionalizimin me kapacitet të plotë të sistemit qendror të klimave	647-24-8094-2-4-7	Procedurë e Vlerës Minimale	X	X	990.00 €	X	X	Anuluar

10	Servisimi dhe pajisje me pjesë të nevojshme për funksionalizimi n me kapacitet të plotë të sistemit qëndror të klimave	647-24-8495-2-4-7	Procedurë e Vlerës Minimale	08.10.2024	Azdren Peci	70,000.00 €	990.00 €	X	X	X	Anuluar
22	Servisimi dhe pajisje me pjesë të nevojshme për funksionalizimi n me kapacitet të plotë të sistemit qëndror të klimave	647-24-8772-2-4-7	Procedurë e Vlerës Minimale	X	X	990.00 €	X	X	X	Anuluar	
23	Dijitalizimi i Arkivës në Administratën Komunale	647-24-9074-2-2-1	Vlerë e mesme Shërbime	08.10.2024	Azdren Peci	70,000.00 €	69,455.00 €		3 muaj	Kontraktuar	
24	Servisimi dhe pajisje me pjesë të nevojshme për funksionalizimi n me kapacitet të plotë të sistemit qëndror të klimavee	647-24-9092-2-4-7	Procedurë e Vlerës Minimale	05.09.2024	X	990.00 €	989.95 €	X	X	Kontraktuar	
25	Rrërimi, Bartja, Magazinimi i Materialeve, Mallrave dhe Objekteve si dhe Hudhja në Deponi te Materialeve dhe Mallrave te	647-24-9221-5-2-1	Vlerë e mesme kornizë Punë	X	X	80,000.00 €	X	X	36 muaj	Anuluar	

26	Sekuistruara - Konfiskuara	647-24-9350-5-1-1	Vlerë e madhe Punë	X	X	774,588.00 €	X	36 muaj	Anuluar
27	Asfaltimi dhe rregullimi i rrugëve dhe rrugicave në qytet (Lagjia Kodra e Minatoreve, Bergjan. Kroi i Vitakeve dhe tek Tre Rokaqet)	647-24-9400-2-2-1	Vlerë e mesme kornizë Shërbime	16.10.2024	Artan Aburrahmani	100,000.00 €	Çmim i peshuar 985.86 €	36 muaj	Kontraktuar 2024-2026
28	Mirembajtja dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik	647-24-9639-2-2-1	Vlerë e mesme kornizë Shërbime	16.10.2024	Enes Jukovic	120,000.00 €	101,307.36 €	36 muaj	Kontraktuar 2024-2026
29	Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në qytet	647-24-9720-5-2-1	Vlerë e mesme kornizë Punë	X	X	80,000.00 €	X	36 muaj	Anuluar
30	Rregullimi, riparimi dhe asfaltimi i rrugëve në Qytet	647-24-9924-5-2-1	Vlerë e mesme Punë	11.11.2024	Aida Sejdiu	200,000.00 €	184,161.50 €	1 muaj	Kontraktuar

31	Rrënimi, Bartja, Magazinimi i Materialeve, Mallrave dhe Objekteve si dhe Hudhja në Deponi të Materialeve dhe Mallrave të Sekuestruara - Konfiskuara	647-24-10624-5-2-1	Vlerë e mesme kornizë Punë	X	X	80,000.00 €	X	36 muaj	Anuluar
32	Rregullimi i Rrugës Mbreti Pjetër, Rruga Vojvode Bojovici dhe Rruga Luj Braj - punë shtesë	647-24-10865-5-2-5	Vlerë e mesme Punë	X	X	18,900.00 €	X	1 muaj	Anuluar
33	Rregullimi, riparimi dhe asfaltimi i rrugëve në Qytet	647-24-10888-2-2-1	Vlerë e mesme kornizë Punë	X	X	80,000.00 €	X	36 muaj	Anuluar
34	Pajisje me Roletna	647-24-11286-1-4-7	Procedurë e Vlerës Minimale	13.11.2024	X	715.00 €	715.00 €	X	Kontraktuar
35	Pastrimi i xhamave pjesa e jashtme	647-24-11328-2-4-7	Procedurë e Vlerës Minimale	X	X	250.00 €	X	X	Anuluar
36	Rregullimi i rrugëve Mbreti Pjetër, Rruga Vojvodë, Bojovici dhe Rruga Luj Braj punë shtesë	647-24-11331-5-2-5	Vlerë e mesme kornizë Punë	09.11.2024	Albin Keimendi	18,900.00 €	18,900.00 €	1 muaj	Kontraktuar
37	Furnizim për Kompiuter Brand Name All IN One	647-24-11495-5-5-8	Mini-tender Furnizim	?	?	20,000.00 €	?	1 muaj	Pritet të nenshkruhet janar 2025
38	Pastrimi i xhamave pjesa e jashtme	647-24-9074-2-2-16	Procedurë e Vlerës Minimale	13.11.2024	X	250.00 €	247.52 €	X	Kontraktuar

39	Asfaltimi dhe rregullimi i rrugëve dhe rrugicave në qytet (Lagjja "Kodra e Minatorëve . Bergjan , Kroi i Vitakëve ,dhe tek Tre Rokaqejt	647-24-11802-5-1-1	Vlerë e madhe Punë	18.12.2024	Albin Kelmendi	774,588.00 €	740,750.19	36 muaj	Kontraktuar
----	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------	--------------------	------------	----------------	--------------	------------	---------	-------------

## Rekomandime për Përmirësimin e Procesit të Prokurimit

Bazuar në analizën e realizuar, disa rekomandime për përmirësimin e procesit të prokurimit për vitin 2025 janë:

- Rritja e mundësive për konkurrencë:** Duhet të zhvillohen strategji të reja për të inkurajuar më shumë ofertues në procedurat e prokurimit, duke ofruar më shumë mundësi për pjesëmarrës të ndryshëm.
- Trajnime të rregullta:** Përdorimi i ekspertëve të fushës për të siguruar që stafi të jetë i përgatitur për të zbatuar ligjin dhe praktikën më të mira të prokurimit.

**3. Zhvillimi profesional:** Sigurimi i mundësive për zhvillimin e aftësive menaxheriale dhe teknike të stafit për të përmirësuar efikasitetin dhe profesionalizmin në procedurat e prokurimit.

**4. Rritja e monitorimit dhe mbikëqyrjes:** Zbatimi i mekanizmave të avancuar të mbikëqyrjes dhe vlerësimit të kontratave për të siguruar që zbatimi i tyre të jetë në përputhje me standardet dhe afatet e përcaktuara.

## 5. Përfundim

### Përfundimi i Raportit të Prokurimit në Komunë

Në përfundim të këtij raporti të prokurimit, mund të vërehet një vlerësim i përgjithshëm pozitiv për implementimin e proceseve të prokurimit në kuadër të aktiviteteve zhvillimore të komunës gjatë vitit 2024. Me gjithë sfidat e natyrshme të menaxhimit të burimeve publike, proceset kanë respektuar standardet e transparencës, barazisë dhe konkurrencës, të cilat janë parimet udhëzuese të legjislacionit kombëtar dhe politikave ndërkombëtare të prokurimit publik.

Në aspektin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të shpenzimeve, është vënë re një përmirësim i konsiderueshëm në përdorimin e teknikave moderne të prokurimit, siç janë tenderët elektronikë dhe monitorimi në kohë reale i zhvillimit të kontratave. Kjo ka kontribuar në një përdorim më të efektshëm të fondeve publike dhe ka rritur besimin e palëve të interesuara në procesin e prokurimit. Megjithatë, ende ka mundësi për avancimin e kapaciteteve të kontrollit të cilësisë gjatë fazës së ekzekutimit të kontratave, sidomos në lidhje me vlerësimin e ofruesve dhe menaxhimin e riskut në projektet me kompleksitet të lartë.

Një sfidë e vazhdueshme mbetet rritja e konkurrencës në disa kategori të prokurimit, ku oferta e operatorëve ekonomikë mund të jetë e kufizuar, çka ndikon në uljen e mundësive për zgjedhjen e mundësive më konkurruese dhe inovative. Pavarësisht këtyre sfidave, procesi ka ruajtur një nivel të lartë të integritetit dhe ka shmangur praktikën e dëmshme, duke respektuar të gjitha kërkesat ligjore dhe etike.

Si rekomandim për vitet e ardhshme, është e nevojshme forcimi i mekanizmave të monitorimit dhe auditimit të kontratave, duke integruar më tej përdorimin e teknologjive të avancuara për menaxhimin e proceseve dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit. Po ashtu, një investim i shtuar në trajnimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit të prokurimit është esencial për të përmirësuar aftësitë analitike dhe menaxhuese, si dhe për të reduktuar ndjeshëm mundësitë për gabime ose parregullsi gjatë implementimit të procedurave.

Në përmbledhje, procesi i prokurimit në komunë ka përmbushur në përgjithësi qëllimet e tij, duke kontribuar në realizimin e projekteve të rëndësishme për zhvillimin lokal. Megjithatë, është e domosdoshme të vazhdojmë me përpjekjet për përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës në prokurim, në mënyrë që të sigurojmë një administrim më të mirë të fondeve publike dhe një ndikim më të madh në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.



## DREJTORIA PER BUXHET, FINANCA DHE ZHVILLIM EKONOMIK

Duke u bazuar në obligimet ligjore për raportim vjetor të Drejtorisë për Buxhet, Financa dhe Zhvillim Ekonomik, më poshtë gjeni raportin për punët e kryera gjatë Vitit 2024 në këto sektore:

- Sektori për Buxhet dhe Financa;
- Zyra për Tatim ne Pronë dhe
- Sektori i Zhvillimit Ekonomik – ARBK.

### 1. SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

#### 1.1 Arka

1.1 Pagesat sipas programeve gjatë vitit 2024 janë:

Programi	Nr. i pagesave	Shuma
Buxhet dhe Financa	0	3.00
Drejtoria e Administrates	0	14,194.00
Inspektimet	0	-
Urbanizmi, Gjeodezi dhe Kadaster		3,304.00
	-	17,501.00

1.2 Aktivitetet tjera gjatë vitit 2024 janë:

Nr	Te tjera	Nr. i pagesave	Shuma
1	Anulim i pagesave	0	-
2	Të pa paguara	0	-
3	Të paguara	206	17,501.00
		206	17,501.00


Nr	Departamenti	Pagesa per sherbim	Pagesa bankare	Total Pagesa
1	Drejtoria për Administratë të Përgjithshme	14,194.00	9,890.00	24,084.00
2	Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport	-	-	-

3	Drejtoria për Çështje të Komuniteteve Lokale dhe Marrëdhënie me Publikun	-	-	-
4	Drejtoria për Financa dhe Zhvillim Ekonomik	3.00	460.00	463.00
5	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirqenie Sociale	-	-	-
6	Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë, Investime dhe Inspektorat	-	-	-
7	Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi	3,304.00	49,216.00	52,520.00
8	Zyra e Kryetarit	-	-	-
9	Zyra e Kuvendit	-	-	-
	<b>Vlera totale</b>	<b>17,501.00</b>	<b>59,566.00</b>	<b>77,067.00</b>

## 1.2 Të Hyrat vetanake gjatë vitit 2024

Nr	Drejtoritë	Realizimi
1	Administrata	42,687.00
2	Buxhetim	493.00
3	Urbanizëm	54,176.50
4	Gjobat nga Inspektorati	2,179.00
Totali		99,535.50

Grafikoni 1. Inkasimi i Të Hyrave Vetanake sipas Drejtorive



## 1.4 Buxheti

Buxheti fillestar i aprovuar në Kuvend Komunal për Komunën e Mitrovicës Veriore është në shumën prej 6,367,531.00 Euro. Grantet Qeveritare marrin pjesë me 6,277,531.00 € , Të Hyrat Vetanake janë në shumën prej 90,000.00 €. Ndërsa të Hyrat Vetanake të bartura nga viti i kaluar (Fondi 22) janë 6,888.34 €.

Pas transferit të aprovuar nga MFPT- Vendimi me nr. 10-030/01-0006449/24 i datës 31.05.2024 kategoria ekonomike Mallra dhe Sherbime është ndikuar pozitivisht në vlerë prej 150,000.00 € , ndërsa kategoria ekonomike Investime Kapitale është ndikuar negativisht për të njëjtën shumë

Në librin e protokollit janë pranuar lëndë, ku disa prej tyre janë mbyllur në intranet e disa të tjera janë përcjellur tek zyrtarët autorizues për shqyrtim dhe procedim të mëtejshëm.

## Gjendja e lëndëve

Nr	Lloji i Kerkeses	Nr. i kërkeses	Refuzuar	Në Proces	TOTALI
----	------------------	----------------	----------	-----------	--------

1	FATURA	1101	0	0	1101
2	KËRKESA PËR UDHETIM ZYRTAR (MEDITJE)	0	0	0	0
3	TË NDRYSHME	0	0	0	0

### 1.5 Gjendja e lëndëve në intranetit

Nr	LËNDET	Totali
1	Lëndët e mbyllura në Intranet	451
2	Lëndët e miratuara	451
3	Lëndët e refuzuara	0

### 1.6 Pagesat

Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka vazhduar me pranimin e faturave (lëndëve) :

*CPO dhe ZOTIME të realizuara*

<b>RAPORTI:</b> <b>JANAR-</b> <b>DHJETOR 2024</b>	<b>Drejtoria /Programet</b>	<b>Nr.i CPO've</b>	<b>Shuma</b>
<b>Nr</b>	<b>Programet &amp; Nenprogramet</b>		
16038	Zyra e kryetarit - Mallra dhe Sherbime	154	51080.78
16038	Zyra e kryetarit - Subvencione nga Fondet 10,21 dhe 22	108	137350.00
16338	Administrata - Mallra dhe sherbime + Kapitale	231	439621.06
16338	Administrata - Komunalite	26	20946.10
16938	Zyra e Kuvendit Komunal	5	898.90
16938	Zyra e Kuvendit Komunal - Subvencione	14	1000.00
18198	Infrastruktura publike+Mallra dhe sherbime + Kapitale	28	957707.29
17538	Buxhetimi - Mallra dhe Sherbime	6	2992.45
16674	Inspektimet - Mallra dhe Sherbime	12	4919.55
16674	Inspektimet- Subvencione	67	21000.00
85038	Sherbime kulturore - Mallra dhe Sherbime	6	584.22
75686	Subvencionet -Shërbimet Sociale 1+3	4	32250.00
92190	Administrata e Arsimit	2	265.02
85118	Sporti dhe Rekreacioni	4	452.02
85118	Sporti dhe Rekreacioni -Subvencione	16	5000.00
18442	Zjarrefiksat-Mallra dhe Sherbime	1	3000.00
75686	Drejtoria e Shendetesis - Subvencione	4	33150.00
73047	Administrata e Shendetesis - Mallra dhe Sherbime	2	406.96
19890	Drejtoria Per Kthim dhe Komunitete - Mallra dhe Sherbime	2	406.96
<b>Totali I Përgjithshme</b>		<b>692</b>	<b>1713031.31</b>

<b>Nr</b>	<b>Programi/et</b>	<b>Nr. i Zotimeve</b>	<b>Shuma</b>
-----------	--------------------	-----------------------	--------------

Programet & Nenprogramet			
16038	Zyra e kryetarit - Mallra dhe Sherbime	154	51080.78
16038	Zyra e kryetarit - Subvencione nga Fondet 10,21 dhe 22	108	137350.00
16338	Administrata - Mallra dhe sherbime + Kapitale	231	439621.06
16338	Administrata - Komunalite	26	20946.10
16938	Zyra e Kuvendit Komunal - Mallra dhe Sherbime	5	898.90
16938	Zyra e Kuvendit Komunal - Subvencione	14	1000.00
18198	Infrastruktura publike+Mallra dhe sherbime + Kapitale	28	957707.29
17538	Buxhetimi - Mallra dhe Sherbime	6	2992.45
16674	Inspektimet - Mallra dhe Sherbime	12	4919.55
16674	Inspektimet- Subvencione	67	21000.00
85038	Sherbime kulturore - Mallra dhe Sherbime	6	584.22
75686	Subvencionet -Shërbimet Sociale 1+3	4	32250.00
92190	Administrata e Arsimit	2	265.02
85118	Sporti dhe Rekreacioni	4	452.02
85118	Sporti dhe Rekreacioni -Subvencione	16	5000.00
18442	Zjarrefiksat-Mallra dhe Sherbime	1	3000.00
75686	Drejtoria e Shendetesis - Subvencione	4	33150.00
73047	Administrata e Shendetesis - Mallra dhe Sherbime	2	406.96
19890	Drejtoria Per Kthim dhe Komunitete - Mallra dhe Sherbime	2	406.96
<b>Totali I Përgjithshëm</b>		<b>692</b>	<b>1713031.31</b>

#### 1.7 Pagesat e realizuara gjatë vitit 2024

Nr	Kategoria Ekonomike	Pagesa	Të rregullta	Vendime Gjyqësore
1	Paga dhe Meditje	843,381.86	843,381.86	-
2	Mallra dhe Shërbime	313,122.36	308,778.08	4,344.28
3	Shpenzime Komunale	21,268.60	20,942.30	326.30
4	Subvencione dhe Transfere 10+21+22	205,500.00	205,500.00	-
5	Investime Kapitale	1,057,332.88	1,057,332.88	-
<b>Totali</b>		<b>2,440,605.70</b>	<b>2,435,935.12</b>	<b>4,670.58</b>

Nr	Pershkrimi	Nr. i kthimeve	Kat. Ekonomike	Shuma e kthimeve
1	Kthim i Mjeteve	0	Mallra&Sherbime	-
2	Kthim i Mjeteve	0	Shpenz. Komunale	-
3	Kthim i Mjeteve	1	Subvencione	500.00
4	Kthim i Mjeteve	0	Inv. Kapitale	-
<b>Totali</b>		<b>1</b>		<b>500.00</b>

Subvencione dhe Transfere pagesa gjithsej gjatë vitin 2024 është 205,500.00 € një pagese e subvencionit e kthyer në vlerë 500.00 € ( xhirollogaria bankare e bllokuar) ,gjithsejt pagesa subvencione dhe trasfere 205,000.00 €

Petty Cash në vlerë 500.00 €- është realizuar në vlerë 499.73€

### 1.8 Kërkesat për anulim

Nr	Lloji i kërkeses për anulim	Numri
1	Anulim i Zotimit	2
2	Anulim i Urdhërbljes	0
3	Anulim i Raportit të pranimi të mallit	1
4	Anulim i kuponit të shpenzimit	0
5	Kërkese për lejim të zotimit pas afatit	1
<b>Totali</b>		<b>4</b>

### 1.9 Kërkesat për ndryshime në paga dhe regjistrim të furnitorëve

Nr	Kërkesat për regjistrim të furnitorëve	Të pranuar MFPT
1	Individ	214
2	Biznes	9
<b>Totali</b>		<b>223</b>

### 1.10.Çertifikimet

Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka vazhduar me pranimin e faturave (lëndëve)

Nr I lëndeve të Çertifikimeve të realizuara

Nr.	Kategoria Ekonomike 130 mallra dhe shërbime	Nr i Çertifikimeve	Shuma
1	Zyra e kryetarit	154	51,079.78
	Administrata	229	169,981.94
	Infrastruktura publike	23	73,741.69
	Inspektimet	12	4,912.16
	Zyra e kuvendit komunal	5	955.21
	Buxheti	6	2,992.18
	Zjarrfiksat Inspektimet	1	2,999.94
	Shërbimet kulturore	6	584.22
	Sporti dhe rekreacioni	4	452.02
	Administrata e arsimit	2	265.02
	Administrata e shëndetësisë	2	406.96
	Arsimi i mesëm	1	4,344.28
	ZKK	2	406.96
<b>Totali Mallra dhe shërbime</b>		<b>447</b>	<b>313,122.36</b>
Nr.	Kategoria Ekonomike 132 shpenzime komunale	Nr i Çertifikimeve	Shuma
1	Zyra e kryetarit	0	
	Administrata	27	21,268.60

Totali Shpenzime Komunale		27	21,268.60
Nr.	Kategoria Ekonomike 200 Subvencione dhe transfere	Nr i Çertifikimeve	Shuma
1	Zyra e kryetarit	116	41,000.00
	Zyra e kryetarit 21	249	89,500.00
	Zyra e kryetarit 22	15	6,300.00
	Zyra e kuvendit komunal	14	10,000.00
	Inspektimet	67	21,000.00
	Shërbime sociale	133	32,700.00
	Sporti dhe rekreacioni	16	5,000.00
Totali Subvencione dhe transfere		610	205,500.00
Nr.	Kategoria Ekonomike 300 Investime kapitale	Nr i Çertifikimeve	Shuma
1	Administrata	5	253,616.50
	Infrastrukturë publike	13	803,716.38
Totali Investime kapitale		18	1,057,332.88
Nr.	Kategoria Ekonomika	Nr. i kthimeve	Shuma e kthimeve
1	Programet & Nënprogramet		
	Zyra e kryetarit 22	1	500.00
			0
Totali		1	500.00

*Note:*  
Të dhënat janë marr nga zyrtaret e Drejtorisë për BFZHE



## 2. RAPORTI I SEKTORIT PËR TATIMIN NË PRONË

Data: 09.01.2025

Raporti paraqitet nga:

**Besnik Asllani, Udhëheqës i Sektorit për Tatimin në Pronë**

Komuna: Mitrovica e Veriut

### 1. Fillimi i punës

Më 23 maj 2024, kam marrë detyrën si Udhëheqës të Sektorit për Tatimin në Pronë në Komunën e Mitrovicës së Veriut. Ky ishte fillimi i angazhimit tim në një sektor të rëndësishëm që ka një rol kyç në stabilitetin financiar dhe zhvillimin e komunës sonë.

### 2. Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve

Më 16 korrik 2024, mora pjesë në një trajnim me temë "Menaxhimi i kontratës dhe vlerësimi i performancës së kontraktorëve", organizuar nga KRPP. Ky trajnim ishte jashtëzakonisht i dobishëm, sepse më mundësoi të përmirësoj aftësitë e mia në menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës, gjë që do të kontribuojë drejtpërdrejt në menaxhimin më efikas të sektorit.

### 3. Rekrutimi i zyrtarëve të rinj

Më 15 korrik 2024, me sukses realizuam rekrutimin e dy zyrtarëve të rinj për Tatimin në Pronë, Marko Radojević dhe Dušan Smikić. Angazhimi i tyre do të forcojë ndjeshëm ekipin tonë dhe do të mundësojë realizimin më efikas të aktiviteteve të planifikuara.

### 4. Takime konsultative dhe shkëmbim përvojash

Gjatë muajit korrik, së bashku me dy zyrtarë për tatimin në pronë nga Komuna e Mitrovicës së Veriut, mora pjesë në një takim konsultativ në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Në takim u takuam me Shefin e Sektorit për Tatimin në Pronë në Mitrovicën e Jugut, ku diskutuam për sfidat në identifikimin dhe regjistrimin e tatimpaguesve. Ky takim ishte një mundësi për shkëmbimin e përvojave dhe gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta për përmirësimin e proceseve në të dy komunat.

### 5. Bashkëpunimi me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

Kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me Departamentin për Tatimin në Pronë brenda Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me qëllim të hartimit të planit të punës për implementimin e Tatimit në Pronë. Ky bashkëpunim është kyç për fillimin e suksesshëm të implementimit në komunën tonë.

### 6. Përgatitjet për implementimin e Tatimit në Pronë në Mitrovicën e Veriut

Kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për fillimin e implementimit të Tatimit në Pronë në Komunën e Mitrovicës së Veriut. Janë siguruar tabletë që do të përdoren në terren për regjistrimin dhe evidentimin e pronave të paluajtshme, duke përmirësuar kështu saktësinë dhe efikasitetin e të dhënave.

## **7. Aktivitetet e ardhshme**

Në ditët në vijim, është planifikuar mbajtja e trajnimit në Departamentin për Tatimin në Pronë brenda Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Pas përfundimit të trajnimit, implementimi i Tatimit në Pronë do të fillojë së shpejti në terren, duke shënuar një fazë të re në punën e sektorit tonë.

---

### **Konkluzion:**

Ky periudhë ka qenë shumë produktive, me përparim të rëndësishëm në organizimin dhe përgatitjet për implementimin e Tatimit në Pronë. Para nesh është një periudhë sfiduese, por edhe emocionuese, në të cilën, përmes punës ekipore dhe mbështetjes së institucioneve relevante, do të arrijmë objektivat e vendosura.

#### **1. Trajnimi një ditor**

Më date 16.08.2024 u mbajt trajnim një ditor nga Departamenti I Tatimit në Pronë – Ministria e Financave ,Punës dhe Transferëve. Në trajnim moren pjese zyrtar nga DTP ,Halime Rrahimi-Rama ,dhe Vehap Hashani ,si dhe zyrtar nga sektori i tatimit në Pronë , Marko Radojević dhe Dušan Smikić si dhe drejtoresha e DBFZHE Mevlyde PECI SHALA . Ky trajnim u mbajt në zyret e tatimit në Pronë ,në Komunën e Mitrovicës Veriore.

Në këtë trajnim u shpjegua se si bëhet evidentimi dhe regjistrimi I Pronave Rezidenciale dhe futja e tyre në sistemin PROTAX .

Po ashtu e shikuam në menyre praktike se si punohet me sistemin Protax në tablet ,si dhe folem për situatë që ndryshem që mund të hasim në terren gjatë punës së përditshme .

#### **2. Konsultime me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve**

Kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me Departamentin për Tatimin në Pronë brenda Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, me qëllim të hartimit të planit të punës për implementimin e Tatimit në Pronë. Ky bashkëpunim është kyç për fillimin e suksesshëm të implementimit në komunën tonë.

#### **3. Aktivitetet e ardhshme**

Përgatitje në vazhdimsi si dhe instalimi i softwereve në Tablet në menyre që gjatë muajit shtatore se bashku me Departamentin e Tatimit në Pronë të filloj implementimi i Tatimit në Pronë në Komunën e Mitrovicës Veriore dhe të na asistojn në terren dhe të fillojm regjistrimin e pronave.

#### **Takimi në Ministrinë e Financave ,Punës dhe Transfereve**

Më date 16.09.2024 në Prishtinë u mbajt takim informues në lidhje me procesin e vlerimit të pronave të paluajtshme për Komunën e Mitrovicës Veriore.

Prezent në takim ishin:

Nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve: Vllaznim Ferataj

Ndërsa nga Komuna e Mitrovicës se Veriut: z. Besnik Asllani , z. Marko Radojevic dhe z.

Dushan Smikiq

Tema kryesore e takimit ishte vlerësimi i përgjithshëm që është zhvilluar këtë vit për pronat bujqësore dhe pyjore. U analizuan dhe u diskutuan zonat e vlerave dhe nivelet e vlerave të cilat

janë caktuar gjatë këtij cikli vlerësimit të përgjithshëm. Po ashtu u prezantuan hartat e vlerave për disa komuna si dhe diskutuam rreth temave të cilat ndërlidhen me tatimin në pronë. Për komunën e Mitrovicës së Veriut për herë të parë këtë vit bëhet vlerësimi i pronave të paluajtshme për qëllime të tatimit në pronë. Këtë vit është bërë vlersimi i pronave bujqesore dhe pujore dhe ndahet në dy zona.

Vitin 2025 parashihet të bëhet vlersimi i pronave rezidenciale dhe industriale ,ndërsa në vitin 2026 vlersimi i pronave komerciale.

### **Takimi – Trajnimi**

Më datë 24.09.2024 në Mitrovicë u mbajt takimi konsultativ si dhe trajnimi për regjistrimin e pronave të paluajtshme . Në takim ishin prezent nga Departamenti i Tatimit në Prone - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve: z. Petrit Popova ,z. Agron Çerkini, z. Vehap Hashani ,znj. Halime Rrahimi-Rama ,znj. Albulenë Bllaca ndërsa nga Komuna e Mitrovicës Veriore :znj. Mevlyde Shala ,z.Besnik Asllani, , z. Marko Radojevic dhe z. Dushan Smikiq.

Në trajnim u moren shembuj praktik me Tablet se si behet regjistrimi i pronave dhe u dakorduam që në ditët vazhim të bëhet informimi i qytetarëve permes mjeteve të informimit .

### **3. Aktivitetet e ardhshme**

Si aktivitet të ardhshme është informimi i vazhduhem i qytetarët lidhje me implementimi e tatimit në Prone në Komunën e Mitrovices Veriore si dhe vazhdimi i anketimit dhe regjistrimi i pronave në terren nga zyrtarët e tatimit në Pronë.

#### **Vizitë Pune në Komunen e Graçanicë**

Datë: 09.10.2024

Vendndodhja: Sektori i Tatimit në Pronë, Graçanicë,

Në takim moren pjesë:

- Besnik Asllani, Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë, Komuna e Mitrovicës Veriore
- Marko Radojeviq, zyrtar për tatimin në pronë,Komuna e Mitrovicës Veriore
- Dushan Smikiq, zyrtar për tatimin në pronë,Komuna e Mitrovicës Veriore
- Srboljub Mitiq, , Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë,Komuna e Graçanicës
- Nenad Stojkoviq, zyrtar për tatimin në Pronë

Qëllimi i vizitës:

Qëllimi i kësaj vizite ishte i shumëfishtë,krahas njohjes me punën në sistemin softuer të ProTax Survey, theksi u vu në përmirësimin e metodologjisë së anketimit të tatimpaguesve, me synim mbledhjen më të saktë të të dhënave dhe llogaritjen më të saktë të taksave. Z. Srboljub Mitić, udhëheqës i Departamentit të Tatimit në Pronë në Graçanicë, ishte nikoqir i takimit dhe ofroi një pasqyrë të detajuar të punës me sistemin e Anketimit ProTax. Takimi u nda në disa faza kyçe që përfshinin në detaje të gjitha aspektet e punës dhe ndërveprimit me sistemin, si dhe punën në terren që përfshinte anketimin e tatimpaguesve.

Njohja me funksionalitetin e avancuar të softuerit ProTax Survey: Z. Mitić prezantoi në detaje funksionalitetet kryesore të softuerit ProTax Survey dhe ofroi një pasqyrë praktike në mënyrën se si sistemi kryen operacionet kryesore.

Theksi vihet në:

- Futja dhe përditësimi i të dhënave në kohë reale: U demonstrua mekanizmi i futjes dhe sinkronizimit të të dhënave për tatimpaguesit dhe pasuritë e tyre, me theks të veçantë në rastet më komplekse.

### **Dalja në terren:**

Më datë 11.10.2024 kemi filluar për herë të parë evidentimin dhe regjistrimin e tatimpaguesve të parë përmes Anketimit me IPAD me sistemin Protax .

Në ditët e para të punës kemi patur probleme të natyrave teknike si vendosja e lokacionit si dhe problem me rrjet që e ka veshitirsu punen në terren ,megjithatë regjistrimi po shkon mir sipas planeve të punes,po ashtu ka interesim të qytetareve që të bëjnë deklarin e pronave të tyre përmes Vetdeklarimit.

Këtë vitë është planifikuar të bëhet regjistrimi i tatimpaguesve të cilët posedojnë Prona Rezidenciale dhe Komerciale , deri më tani janë regjistruar 93 posedues të pronave ,ku të gjitha të regjistruara janë Prona Rezidenciale .

Muajin Tetor 93 prona Rezidenciale të regjistruara

### **Vizitë nga Kfori Hungarez:**

Më datë 31.10.2024 ishin në vizitë përfaqësues të kontigjentit Hungarez (KFOR) ,departamenti për siguri dhe raporte sociale.

Në takim moren pjesë:

Besnik Asllani, Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë, Komuna e Mitrovicës Veriore,

Peter Csontos Kfori Hungarez,

Zsombor Demeter Kfori Hungarez,

Ibrahim Delija Përkthyes .

Në takim u diskutua rreth procesit të regjistrimit të Pronave Rezidenciale , i informova në pika të shkurta se si po shkon procesi i regjistrimit të pronave , po ashtu ishin të interesuar të din se sa është intersimi i qytetareve të vetëdeklarohen dhe si po shkon procesi në përgjithsi.

### **Pjesmarrje në puntorin e organizuar nga MFPT-Departamenti i Tatimit Pronë**

Datë: 06.11.2024

Vendndodhja: Hotel Sirius – Prishtinë

Në puntori moren pjesë:

Zyrtar nga katër Komunat Veriore të Kosovë si dhe zyrtare nga Komunat tjera të Kosovës,

Nga Komuna e Mitrovicës Veriore moren pjesë:

Mevlyde PEÇI SHALA – Drejtore e DBFZHE

Besnik Asllani, Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë, Komuna e Mitrovicës Veriore

Marko Radojeviq, zyrtar për tatimin në pronë,Komuna e Mitrovicës Veriore

Dushan Smikiq, zyrtar për tatimin në pronë,Komuna e Mitrovicës Veriore

Në puntori u prezantuan se si bëhet regjistrimi i tatimpaguesve fizik dhe juridik,po ashtu raste studimore të ndryshme të regjistrimit të pronave dhe tatimpaguesve në terren ,po ashtu u diskutu dhe demonstru :

- Procesi i krijimit të lidhjes së pronës/ave dhe tatimpaguesit/ve fizik dhe juridik.
- Gabimet më të shpeshta që ndodhin gjatë shkëputjes dhe rikrijimit të lidhjes së tatimpaguesve.
- Pasojat nga shkëputjet e gabueshme të lidhjes dhe ri-rregullimi i lidhjes
- Procesi-veprimi i drejtë para shkëputjes së lidhjes ndërmjet pronës dhe tatimpaguesit
- Procesi-Modifikimi/Ndrrimi i një apo ma shumë tatimpaguesi-ve fizik me një apo ma shumë tatim. fizik . Si dhe u ndan përvoja të ndryshme nga koleget e Komunave të tjera në Kosovë si dhe me sfidat që përballen gjatë punës së përditshme.

Gjatë muajit Nëntor janë bërë gjithsej 131 regjistrime të pronave të paluajtshme prej tyre:

Prona Rezidenciale 129

Prona Komerciale 2

Muaji dhjetor ka qenë muaj në të cilin janë bërë më se shumti regjistrime të pronave të paluajtshme .

Gjatë muajit dhjetor janë bërë gjithsej 229 regjistrime të pronave të paluajtshme prej tyre:

Prona Rezidenciale 222

Prona Komerciale 7

Gjatë vitit 2024 prej anketimit të parë në terren me datë 11.10.2024 deri me datë 31.12.2024 janë bërë gjithsej 453 regjistrime të poseduesve të pronave të paluajtshme ,ku prej tyre :

Prona Rezidenciale 444


Prona Komerciale 9

### 3. SEKTORI PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK

*Numrin i bizneseve që janë regjistruara në vitin 2024, dhe statistikave ndër vite.*

 **Aktive**

 **Shuara**



*Numri total i Bizneseve të regjistruara është 121*


*Biznese të hapura janë 120*

*Biznese të mbyllura janë 01*

*Ndarja sipas gjinis së pronarëve.*

Femër / Mashkull	Femër	Mashkull
<b>Totali</b>	<b>36</b>	<b>84</b>


## Statistikat Femër Mashkull ARBK 2024



*Gjithësej janë 120 biznese, 36 biznese me pronare Femër dhe 84 biznese me pronar Meshkuj.*

Statistika nga regjistri i bizneseve të grupuara sipas llojit të biznesit	B.I	73
	SH.P.K	47
<b>Totali</b>	<b>B.I &amp; SH.P.K</b>	<b>120</b>





*Sipas statistikave nga regjistri i bizneseve te grupuara sipas llojit te biznesit 73- B.I - Biznese individuale dhe - SH.P.K Shoqëri me përgjithësi te kufizuar.*

*Gjatë vitit 2024 kanë qenë disa kërkesa për zgjatjen e orarit të bizneseve të gastronomisë,*

*Të cilat në bazë të kërkesave që janë bërë janë shqyrtuar në pajtueshmëri me ligjin dhe rregulloren në vijim,*

Bazuar në Nenin 44 dhe 73 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurë të Përgjithshme Administrative, Neni 20 të Rregullore Komunale Nr. 04/2023 për orarin e punës të subjekteve afariste, hoteliere, zejtare dhe shërbyese në territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore.

*Gjithësej kanë qenë shtatë kërkesa, ku prej të cilave gjashtë janë aprovuar dhe një është refuzuar.*

## ZYRA LIGJORE

- Bazuar në kërkesën për raportin vjetor, zyra ligjore në komunën e Mitrovicës Veriore sipas detyrave të saj zyrtare për periudhën Janar-Dhjetor 2024 ka kryer punët si në vijim:

### Aktivitetet e përgjithshme

- Për vitin kalendarik 2024 zyra ligjore ka ofruar këshilla dhe konsulta ligjore për nevojat e gjitha drejtorive dhe kabinetit të kryetarit përfshirë përpilimin e akteve, shkresave etj.
  - Me vendim të kryetarit janë caktuar zyrtarët ligjor anëtar /kryesues të komisioneve- grupeve punuese për hartimin e Rregulloreve komunale.
  - Me vendim të kryetarit është caktuar zyrtari ligjor anëtar i komisionit për zhvillimin e procedurave për ndërrimin e vulës të zyrës për Gjendjen Civile (procedura e iniciuar është përfunduar).
  - Me vendim të kryetarit është caktuar zyrtari ligjor antar i komisionit për hartimin e Planit të Veprimit për Integrimin e Komunitetit Rome, Ashkali dhe Egjiptas 2024-2027 (për gjatë vitit kalendarik është mjetur vetëm një takim informues).
  - Me vendim të kryetarit është caktuar zyrtari ligjor antar në komisione për zhvillimin e procedurave të rekrutimit të stafit të ri (procedurat për komisionet e cekura janë të përfunduara).
  - Me vendim të kryetarit është caktuar zyrtari ligjor kryesues i komisionit disiplinor për zhvillimin e procedurave disiplinore (të gjitha procedurat e iniciuara janë të përfunduara).
  - Me vendim të kryetarit është caktuar zyrtari ligjor përgjegjës për pranimin dhe trajtimin sinjalizimit në institucionin e komunës së Mitrovicës Veriore, i cili ka mbajtur trajnime për këtë fushë.
  - Me vendim të kryetarit është caktuar zyrtari ligjor Koordinator për raportim të performancës komunale, i cili ka marrë pjesë në trajnime dhe kryerjen e aktiviteteve që lidhen me performancën komunale.
  - Me vendim të kryetarit është caktuar zyrtari ligjor përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit komunal, dhe për këtë është raportuar pranë Agjencionit për parandalimin e korrupsionit.
  - Me kërkesë të Kryetarit zyra ligjore ka përpiluar Memorandum bashkëpunimi me Policinë e Kosovës për shfrytëzimin e veturave zyrtare.
  - Me vendim të kryetarit është caktuar zyrtari ligjor-anëtar i komitetit koordinues në komunën e Mitrovicës Veriore për zbatimin e planit kombëtar të veprimit për qeverisje të hapur 2023-2025 (komiteti koordinues ende nuk ka mbajtur aktivitet në këtë drejtim).
  - Përfaqësuesi ligjor i komunës ka marrë pjesë në trajnimin 4 ditor të organizuar nga Asociacioni i komunave të Kosovës me temë: Zhvillimi i Procedurave Gjyqësore
  - Sipas vendim të datës: 16.12.2020 është emëruar zyrtari për mbrojtje nga diskriminimi, i cili në vazhdimësi në koordinim me zyrën për të drejtat e njeriut në kuadër të MAPL-së dhe Zyrën e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë, mbajnë aktivitete që mulojnë fushën për promovimin, avasimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut (për këtë vit është mbajtur fushatë vetëdijesuese për trafikimin me qenje njerëzore).
  - Gjatë vitit 2024 nuk ka pasur asnjë aktakuz të ngritur ndaj zyrtareve komunal dhe si rrjedhojë nuk ka pasur as pezullime
  - Nga zyra ligjore zyrtari përgjegjës ka marrë pjesë në kolegjiun e zyrtareve ligjor të organizuar nga Asociacioni i komunave të Kosovës.
- Lehtësimi i barrës administrative**
- Me vendim të kryetarit janë caktuar zyrtarët ligjor në komisionin për zhvillimin e procedurës për lehtësimin e barrës administrative ( nga takimet e mbajtura dhe zhvillimin e kësaj procedure janë thjeshtëzuar 10 (dhjetë) shërbime administrative nga drejtorit të ndryshme).

**Tabela me shërbimet e thjeshtuara të Komunës së Mitrovicës Veriore**

Nr.	EMRI I SHËRBIMIT	EMRI I DOKUMENTIT QË NUK KËRROHET MË (nga Pala) PËR MARRJEN E SHËRBIMIT
<b>ZYRA E KRYETARIT</b>		
1.	Aplikimi në konkurs për pranim në shërbimin publik	1.Kopja e diplomës e vertetuar te noteri
<b>DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME</b>		
2.	Akti i vdekjes	1.Ekstraktet e lindjes për personat në jetë
3.	Regjistrimi i mëvonshëm i lindjeve	1.Ekstraktet e lindjes së prinderve 2.Certifikata e martesës së prinderve
4.	Regjistrimi i mëvonshëm i vdekjeve	1.Ekstrakti i lindjes së të vdekurit 2.Certifikata e martesës e prinderve të të vdekurit
5.	Kurorëzimet	1.Ekstraktet e lindjes 2.Certifikata e martesës
6.	Kërkesë për dëshminë e vdekjes	1.Leternjoftimi kopje 2.Certifikata e vdekjes kopje 3.Lista poseduese kopje
<b>DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE INSPEKSION EMËRGJENCA DHE SIGURI</b>		
7.	Kërkesa për aplikim për ndërtimin dhe renovimin e shtëpiave	1.Leternjftimi kopje 2.Ekstrakti kopje 3.Lista poseduse kopje 4.Kopje e planit kopje 5.Deklarata e bashkësisë familjare
8.	Kërkesë për kyqje dhe hapjen e kanalizimit	1.Leternjoftimi kopje 2.Lista poseduese kopje 3.Kopja e planit kopje
9.	Kërkesë për bllokimin e rrugëve për shkakë të punimeve në rrugë	1.Leternjoftimi kopje 2.Lista poseduese kopje 3.Kopja e planit kopje
<b>DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA</b>		
10.	Kërkesë për zgjatjen e orarit për lokalet afariste	1.Leternjoftimi kopje 2.Çertifikata e biznesit kopje

**Rregulloret komunale të hartuara nga zyra ligjore në bashkëpunim me drejtorit përkatëse:**

Numri rendor	Emërtimi	Data
1.	Rregullore komunale për taksa tarifa dhe gjobat komunale	Janar-2024

2.	Regullore komunale për transportin rrugor në territorin e komunës së Mitrovicës Veriore	Shtator-2024
3.	Rregullore komunale për menaxhimin e parkingjeve publike dhe shërbimin e transportit me “Merimange” në teritorin e komunës së Mitrovicës Veriore	Dhjetor 2024
4.	Rregullore komunale për përdorimin e gjuhëve	Dhjetor 2024

## Përfaqësimi ligjor pranë gjykatave

### Janar 2024

Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera	Data
Përfaqësim në seancë gjyqësore	05.01.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	15.01.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	17.01.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	19.01.2024
Ankesë për lëndën C.nr.508/16	22.01.2024
Ankesë për lëndën C.nr 68/2011	22.01.2024
Padi kundër Rajoni .org	22.01.2024
Ankese ne KPM	22.01.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	29.01.2024

### Shkurt 2024

Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera	Data
Përfaqësim në seancë gjyqësore	01.02.2024
Perpelim i përgjigjes ne padi	06.02.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	15.02.2024

### Mars 2024

Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera	Data
Përfaqësim në seancë gjyqësore	06.03.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	12.03.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	12.03.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	18.03.2024
Përpelim i kallëximit penal	20.03.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	22.03.2024

### Prill 2024

Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera	Data
Përfaqësim në seancë gjyqësore	16.04.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	18.04.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	18.04.2024

Përpilim dhe dorëzim i parashtrësës	18.04.2024
Kërkesë për informatë për policinë e kosoves për rastin e 60 pagave të pezulluara	19.04.2024
Përpilim i ankesës	23.04.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	24.04.2024

#### Maj 2024

<b>Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera</b>	<b>Data</b>
Përfaqësim në seancë gjyqësore	10.05.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	15.05.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	15.05.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	15.05.2024
Përpilim i parashtrësës për prokurorinë themelore Mitrovice	15.05.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	16.05.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	29.05.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	30.05.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	31.05.2024

#### Qershor 2024

<b>Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera</b>	<b>Data</b>
Përfaqësim në seancë gjyqësore	11.06.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	19.06.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	20.06.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	20.06.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	21.06.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	24.06.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	24.06.2024
Përpilim dhe dorëzim i prapsimit kundër Inspektoratit të Punës	26.06.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	27.06.2024
Përpilim i shkresës për MSH	27.06.2024
Përpilim i shkresës për MASHT	27.06.2024

#### Korrik 2024

<b>Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera</b>	<b>Data</b>
Përfaqësim në seancë gjyqësore	01.07.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	03.07.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	03.07.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	10.07.2024
Përpilimi i propozimit për përmbarrim dhe dërgimi i lëndës të përmbarruesi privat	18.07.2024

**Gusht 2024**

<b>Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera</b>	<b>Data</b>
Përfaqësim në seancë gjyqësore	01.08.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	22.08.2024
Përpilim i përgjigjes në padi	30.08.2024

**Shtator 2024**

<b>Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera</b>	<b>Data</b>
Përfaqësim në seancë gjyqësore	12.09.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	13.09.2024
Përpilim i përgjigjeve në padi për 4 lëndë	16.09.2024
Përpilim i ankesës per lëndën C.nr 2243/23	16.09.2024
Përpilim i kallëximit penal	19.09.2024

**Tetor 2024**

<b>Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera</b>	<b>Data</b>
Përfaqësim në seancë gjyqësore	07.10.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	10.10.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	14.10.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	17.10.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	17.10.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	25.10.2024
Përfaqësim në seancë gjyqësore	11.10.2024

**Nëntori 2024**

<b>Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera</b>	<b>Data</b>
Përpilim i përgjigjes ne padi C.nr 284/2018	25.11.2024
Përpilim i përgjigjes ne padi C.nr 317/2018	25.11.2024

**Dhjetor 2024**

<b>Aktivitetet e mbajtura: Seancat, padite, ankesat, kallximet penale dhe shkresat tjera</b>	<b>Data</b>
Përfaqësim në seancë gjyqësore	05.12.2024
Përpilim i ankesës KPPP NR 1235/24	12.12.2024



# ZYRA PËR INFORMIM

## Raporti i Punes i Zyrës për Informim për Periudhën Janar-Dhjetor 2024

Në përputhje me kërkesën për raportin vjetor për vitin 2024, Zyra për Informim në Komunën e Mitrovicës Veriore ka realizuar shumë aktivitete dhe angazhime gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024. Ky raport ka për qëllim përmbledhjen dhe pasqyrimin e detajuar të aktiviteteve, angazhimeve dhe detyrave të realizuara nga Zyra për Informim, me fokus të veçantë në rolin e saj të rëndësishëm në mbështetje të transparencës dhe komunikimit ndërmjet administratës komunale, Kryetarit të Komunës dhe qytetarëve. Gjithashtu, në këtë raport janë përfshirë përpjekjet për përmirësimin e kanaleve të informimit dhe mënyrat e reja të komunikimit me publikun.

## Aktivitete dhe Angazhime të Zyrës për Informim (Janar-Dhjetor 2024)

### 1. Përshtatja dhe Përditësimi i Webfaqes Zyrtare të Komunës:

Në periudhën e analizuar, Zyra për Informim ka pasur një rol kyç në ri-dizajnimin dhe përditësimin e webfaqes zyrtare të Komunës së Mitrovicës Veriore. Ky proces ka përfshirë jo vetëm një përditësim të informacionit dhe përmirësimin e strukturës së faqes, por gjithashtu pasurimin e përmbajtjes dhe përshtatjen e saj për një navigim më të lehtë nga qytetarët. Ky hapi ka pasur për qëllim sigurimin e një forme më efektive të komunikimit dhe informimit me qytetarët deri në dizajnimin dhe lansimin e Webfaqeve të reja.

### 2. Publikimi i Vendimeve dhe Materialeve:

Zyra për Informim ka pasur një angazhim të vazhdueshëm në dokumentimin dhe shpërndarjen e vendimeve të marra nga Zyra e Kryetarit, si dhe publikimin e materialeve dhe dokumenteve të tjera nga drejtorit e ndryshme të Komunës, si Drejtoria e Financave, Drejtoria e Administratës së përgjithshme, Drejtoria për Kulturë, rini dhe sport, Zyra e Prokurimit etj. Publikimi i këtyre materialeve ka për qëllim përmirësimin e transparencës dhe qasjen e qytetarëve në informacionin që i përket politikave dhe aktiviteteve të Komunës.

### 3. Aktivitetet në Rrjetet Sociale dhe Kanale të Tjera të Informimit:

Një nga angazhimet kryesore të Zyrës për Informim ka qenë rritja dhe përmirësimi i pranisë dhe komunikimit në rrjetet sociale. Për këtë qëllim, janë hapur dhe menaxhuar llogaritë në rrjete sociale si Instagram, Twitter dhe YouTube, duke përdorur gjithashtu llogaritë ekzistuese si Facebook dhe profilin zyrtar të Kryetarit të Komunës, për shpërndarjen e informacionit në kohë reale për aktivitete të ndryshme të Kryetarit të Komunës dhe të drejtorive komunale. Zyra ka pasur një angazhim të vazhdueshëm për të informuar qytetarët mbi aktivitetet e Kryetarit, takimet dhe vizitat, si dhe pjesëmarrjen në ngjarje publike, aktivitete kulturore dhe edukative, përmes këtyre platformave.

### 4. Përcjellja dhe Publikimi i Aktiviteteteve të Kryetarit të Komunës:

Zyra për Informim ka ndjekur dhe raportuar aktivitete të ndryshme të Kryetarit të Komunës, duke përfshirë takimet brenda dhe jashtë komunës me institucione të tjera dhe partnerë ndërkombëtarë. Zyra ka monitoruar gjithashtu ndikimin e këtyre aktiviteteve tek qytetarët.

## **5. Aktivitetet dhe Ngjarjet Publike të Komunës:**

Përmes platformave të ndryshme informuese, Zyra për Informim ka siguruar informacione për qytetarët lidhur me aktivitete dhe ngjarje të rëndësishme për Komunën dhe shoqërinë, duke përfshirë evenimente edukative, kulturore dhe ekologjike. Disa prej aktiviteteve më të rëndësishme që janë përkujdesur për to janë: “Dita e Pastrimit të Botës” më 20 shtator, “Muaji i Ndërgjegjësimit Kundër Kancerit të Gjitit” në muajin tetor, aktivitete kulturore si Green Festival (edizioni i 14-të), Mitrovica Guitar Days dhe përkujtimi i 70-vjetorit të lindjes së heroit Kadri Kadriu. Po ashtu, u organizuan ligjërata dhe aktivitete për nxënësit e shkollave fillore, duke përfshirë temat e rëndësishme si parandalimi i trafikimit me njerëz.

## **6. Informimi për Investimet në Infrastrukturë:**

Një tjetër fushë e rëndësishme e punës së Zyrës për Informim ka qenë informimi i qytetarëve për investimet dhe ecurinë e projekteve të infrastrukturës në Komunë. Pjesë e këtij angazhimi ka qenë shpërndarja e informacionit për rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve në Lagjen e Boshnjakëve dhe në qendër të qytetit, duke përdorur fotografi dhe përditësime të detajuara për qytetarët.

## **7. Publikimi i Njoftimeve të ndryshme:**

Zyra ka informuar qytetarët për njoftimet e rëndësishme nga drejtoritë përkatëse të Komunës, përfshirë njoftimet për dëgjime publike, rastet emergjente dhe mundësitë për subvencione që Komuna ofron për qytetarët.

## **8. Caktimi i Zyrtarëve për Informim në proceset Zyrtare:**

Me vendim të Kryetarit, janë caktuar zyrtarë për monitorimin e proceseve të ndryshme:

- Me vendim të kryetarit caktohet zyrtari për informim, zyrtar përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtare.
- Me vendim të kryetarit caktohet zyrtari për informim, zyrtar përgjegjës për dëgjime publike.
- Me vendim të kryetarit caktohet zyrtari për informim, zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të marrëveshjes ndërmjet StrayCoco dhe Komunës së Mitrovicës Veriore për trajtimin e qenve endacak.
- Me vendim të kryetarit caktohet zyrtari për informim, zyrtar përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit në seancat e Kuvendit Komunal, Komitetit për Komunitete dhe Komisionit për Politikë dhe Financa.
- Me vendim të kryetarit caktohet zyrtari për informim, anëtar në komision për rekrutimin e stafit.

## **9. Trajnime Profesionale për Zyrtarët për Informim:**

Në periudhën e analizuar, zyrtarët për informim kanë kaluar një sërë trajnimesh dhe aktivitete zhvillimore siq janë:



- Trajnim për nëpunësit e ri,
  - Trajnim për qasjen në gazetën zyrtare të Kosovës,
  - Trajnim për përdorimin e webfaqeve të reja të Komunës,
  - Trajnim për performancën komunale dhe përdorimi i Intelegjencës artificiale
  - Trajnim për Komunikimin në Emergjenca Publike/situata krizash.
- 

## **Përfundim dhe Vlerësim i Performancës së Zyrës për Informim:**

Zyra për Informim ka pasur një rol të pandërprerë dhe të rëndësishëm në përmirësimin e komunikimit dhe transparencës ndërmjet Komunës dhe qytetarëve gjatë vitit 2024.

Aktivitetet e realizuara dhe angazhimet e Zyrës për Informim kanë kontribuar në rritjen e nivelit të angazhimit të qytetarëve dhe përmirësimin e lidhjeve me administratën komunale. Pjesëmarrja e vazhdueshme në zhvillimin e komunikimit të dyanshëm, si dhe përmirësimi i kanaleve të informacionit, kanë siguruar që qytetarët të kenë qasje të lehtë në informacionet e nevojshme për jetën e përditshme dhe proceset vendimmarrëse në Komunë.

Zyra do të vazhdojë të investojë në rritjen e efikasitetit të komunikimit dhe të mbajë një nivel të lartë transparence dhe përgjegjshmërie ndaj qytetarëve dhe institucioneve.

## DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Për kryerjen e detyrave të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Inspektimit organizohet në sektorët e mëposhtëm:

Spektori i Inspektimit të Shërbimeve Komunale

Spektori i Inspektimit të Ndërtimit

Gjatë kryerjes së aktiviteteve të mëposhtme:

- Mbikëqyrë dhe inspekton të gjitha dukuritë negative që hasen në territorin e komunës së Prishtinës;
- Mbikëqyrë dhe verifikon nëse shtetasit në administrim të pasurisë së tyre, zbatojnë ose plotësojnë kërkesat e akteve komunale;
- Të ndalojë uzurpimin e paligjshëm të trojeve, ndërtesave dhe objekteve të komunës si dhe të organizojë lirimimin e tyre;
- Përcjellë procesin e ndërtimeve, ndryshimeve, shndërrimeve, si dhe rrënimit të objekteve;
- Përcjellë rrjetin e ujësjellësit, kyçjet pa leje në rrjet, si dhe parandalimin e keqpërdorimit të ujit të pijshëm;
- Mbikëqyrë kyçjet ilegale në rrjetin e kanalizimit publik, ndërhyrjen (prerjen) e rrugëve publike pa leje, të trotuareve dhe të sipërfaqeve tjera publike;
- Mbikëqyrë mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, shesheve, parqeve, varrezave, tregut të gjelbër, terreneve sportive dhe sipërfaqeve të tjera publike;
- Monitoron lidhjen e paligjshme në rrjetin publik të kanalizimeve, pengimin (kryqëzimin) e paautorizuar të rrugëve publike, trotuareve dhe hapësirave të tjera publike;
- Mbikëqyr mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, shesheve, parqeve, varrezave, tregjeve, terreneve sportive dhe hapësirave të tjera publike;
- Monitoron ujin, objektet dhe pajisjet për furnizimin me ujë të pijshëm;
- Kontrollon aktivitetet industriale që mund të shkaktojnë ndotje të ajrit, tokës dhe ujit;
- Mbikëqyrë ujin, objektet si dhe aparatet për furnizimin me ujë të pijshëm;
- Është përgjegjëse për konfiskimin e mallit të dyshimtë, të prishur që paraqet rrezik për shëndetin publik dhe asgjësimin e tij, në përputhje me rregullat dhe procedurat në fuqi;
- Inspekton veprimtaritë industriale që mund të shkaktojnë ndotjen e ajrit, dheut dhe ujit, që shkaktohen;
- Inspekton dokumentacionin teknik (projektet e ndërtimit, lejet e ndërtimit, inspektimin final të vendndërtimit);
- Inspekton procesin e ndërtimit në të gjitha fazat dhe verifikon përputhshmërinë me dokumentacionin ndërtimor;
- Sigurohet që janë ndërmarrë masat adekuate të sigurisë së objekteve në ndërtim, objekteve të tjera përreth dhe komunikacionit;
- Vërteton saktësinë dhe origjinalitetin e dokumentacionit, të cilat investitori duhet t'i ketë në dispozicion në vendndërtim, në përputhshmëri me ligjin;
- Përpilon procesverbalet për gjendjen e punimeve në vendndërtim, duke vlerësuar respektimin e kushteve të përcaktuara për ndërtim, cilësinë e punimeve dhe të materialit ndërtimor;
- Merr vendime për ndërprerjen e ndërtimit, në rast t'jë mospërputhjeve me kërkesat e lejes ndërtimore;
- Marr vendime për rrënimin e objekteve të ndërtimit, në rast të mospërputhjes me kërkesat e lejes ndërtimore.
- Kujdeset që gjendja shëndetësore të personave të cilët për shkak të veprimtarisë së tyre mund të rrezikojnë shëndetin e popullatës;
- Mbikëqyrë ekspozimin e mallrave jashtë lokaleve afariste, ndalimin e shfrytëzimit

- (vendosjes) pa leje të hapësirave publike, vënien e mbishkrimeve, reklamave, vitrinave, objekteve publike dhe higjienike, hoteliere, sallave publike;
- Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave për vënien e panove dhe të reklamave të të gjitha llojeve;
  - Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore nga lëmi i komunikacionit dhe të mjeteve motorike në qarkullimin publik;
  - Mbikëqyrë, kontrollon dhe marr masa të parapara ligjore, kundër transportuesve ilegalë dhe të atyre që nuk e respektojnë orarin e caktuar nga organi kompetent;
  - Inspekton rrugët publike në të cilat kryhen punimet rrugore gjatë projektimit, ndërtimit, rikonstruktimit, mirëmbajtjes sinjalizimit horizontal dhe vertikal;
  - Inspekton zbatimin e planit të menaxhimit të sigurisë së përgjithshme rrugore brenda brezit të sigurisë rrugore (projektimit, ndërtimit, rikonstruktimit, mirëmbajtjes, sinjalistikës rrugore);
  - Inspekton transportin publik urban, urban periferik dhe të mallrave;
  - Inspekton transportin e mbingarkesave boshtore dhe atë jashtë gabariteve të transportuesve të ndryshëm;
  - Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore për zonat e mbrojtura të natyrës nga kontaminimi, mbeturinat dhe materiet rrezikshme;
  - Inspekton aktivitetet që shkaktojnë çrregullime të përgjithshme në ambient dhe identifikon palën përgjegjëse, e cila ka shkaktuar çrregullime;
  - Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore që mbrojnë ujin, ajrin, dheun nga ndotja;
  - Mbikëqyrë zbatimin e dispozitave ligjore për menaxhimin dhe eksploatimin e resurseve natyrore (prerja e pyjeve, nxjerrja e rërës nëpër lumenj etj.) nga aspekti i mbrojtjes së ambientit;
  - Inspekton punën e gurthyesve;
  - Monitoron shërbimet publike komunale, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e ambientit (menaxhimin e mbeturinave, kanalizimit, ujit dhe shërbimeve tjera publike për parandalimin e ndotjes së ambientit);
  - Është përgjegjëse për planifikimin lokal të ambientit, masat për konservimin e natyrës, masat tjera mbrojtëse ndaj zhurmës, trafikut etj;
  - Kryen edhe punë të tjera, në përputhje me ligjet e aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë.
  - Kontrollon dokumentacionin teknik (projektet e ndërtimit, lejet e ndërtimit, inspektimi përfundimtar i kantierit);
  - Kontrollon procesin e ndërtimit në të gjitha fazat dhe kontrollon përputhshmërinë me dokumentacionin e ndërtimit;
  - Të sigurohet që janë marrë masat e duhura të sigurisë për ndërtesat në ndërtim, ndërtesat e tjera përreth dhe trafikun;
  - Verifikon saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit që investitori duhet të ketë në dispozicion në kantier, në përputhje me ligjin;
  - Përpilon një raport për gjendjen e punimeve në kantier, duke vlerësuar plotësimin e kushteve të ndërtimit, cilësinë e punimeve dhe materialeve të ndërtimit;
  - Merr vendime për pezullimin e ndërtimit në rast të mosplotësimit të kërkesave të lejes së ndërtimit;
  - Merr vendime për prishjen e objekteve në rast të mosplotësimit të kërkesave të lejes së ndërtimit.
  - Kujdeset për sigurimin e shëndetit të personave, veprimet e të cilëve mund të rrezikojnë shëndetin e popullatës;
  - Mbikëqyr ekspozimin e mallrave jashtë objekteve afariste, ndalon shfrytëzimin (vendosjen) e paautorizuar të hapësirave publike, vendosjen e reklamave, reklamave, vitrinave, objekteve publike dhe sanitare, hoteleve dhe sallave publike;
  - Mbikëqyr zbatimin e rregulloreve për vendosjen e tabelave dhe reklamave të të gjitha

- llojeve;
- Mbikëqyr zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e komunikacionit dhe mjeteve motorike në transportin publik;
  - Mbikëqyr, kontrollon dhe merr masa të përcaktuara me ligj ndaj transportuesve të paaautorizuar dhe atyre që nuk respektojnë orarin e përcaktuar nga autoriteti kompetent;
  - Inspekton rrugët publike në të cilat kryhen punimet rrugore gjatë projektimit, ndërtimit, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së sinjalistikës horizontale dhe vertikale;
  - Kontrollon zbatimin e planit të përgjithshëm të menaxhimit të sigurisë në komunikacion brenda brezit të sigurisë (projektim, ndërtim, rikonstruksion, mirëmbajtje, sinjalistikë rrugore);
  - Inspekton transportin publik urban, periferik dhe mallrash;
  - Kontrollon transportin e mbingarkesave në bosht dhe ngarkesave të mëdha të transportuesve të ndryshëm;
  - Mbikëqyr zbatimin e dispozitave ligjore për zonat e mbrojtura natyrore nga ndotja, mbetjet dhe materialet e rrezikshme;
  - Heton aktivitetet që shkaktojnë shqetësime të përgjithshme mjedisore dhe identifikon palën përgjegjëse që ka shkaktuar shqetësimet;
  - Monitorimi i zbatimit të dispozitave ligjore që mbrojnë ujin, ajrin dhe tokën nga ndotja;
  - Mbikëqyr zbatimin e dispozitave ligjore për menaxhimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore (shpyllëzimi, nxjerrja e rërës nga lumenjtë etj.) nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit;
  - Kontrollon funksionimin e gurores;
  - Monitoron shërbimet e shërbimeve publike në lidhje me mbrojtjen e mjedisit (menaxhimi i mbetjeve, ujërave të zeza, ujit dhe shërbimeve të tjera publike për parandalimin e ndotjes së mjedisit);
  - Përgjegjës për planifikimin mjedisor vendor, masat për mbrojtjen e natyrës, masat e tjera të mbrojtjes nga zhurmat, trafikun etj.;
  - Të sigurojë dhe të marrë masa për të siguruar që toka bujqësore të mos përdoret për qëllime jo bujqësore,
  - Kryen edhe punë të tjera, në përputhje me ligjet në fuqi në kuadër të fushëveprimit të Drejtorisë.

## PËRMBLEDHJE

Raporti i punës së Drejtorisë e Inspeksionit, paraqet përmbledhje të punëve, aktiviteteve dhe veprimeve të ndërmarra në zbatim të dispozitave relevante ligjore dhe nënligjore, Planit të Punës dhe në trajtim të kërkesave të parashtruara institucioni tonë dhe rasteve ad-hoc të paraqitura. Në ushtrimin e funksionit, bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë juridike, Drejtoria e Inspeksionit konsideron se ka përmbushur planin vjetor të punës të vitit 2024 për periudhën Janar-Dhjetor.

### 1. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

- Inspektimi i veprimtarive-subjekteve afariste;
- Trajtimi i kërkesave zyrtare;
- Trajtimi i rasteve ad-hoc;
- Përpilimi i procesverbaleve, raporteve, konkluzioneve, vendimeve etj. dhe ekzekutimit i tyre;
- Inicimi i procedurave kundërvajtëse dhe kallëzime penale.

Aktivitetet në fjalë zëbërthehen në aktivitetet dhe veprime konkrete të cilat realizohen në bazë të planit ditor të Drejtorisë së Inspeksionit.

## 2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

### 2.1. Sektori i Shërbimeve Komunale:

- Inspektime për shfrytëzimin e hapësirave publike;
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit publik dhe kanalizimit atmosferik;
- Inspektimi i kooperdorimit të ujit të pijshëm dhe shfrytëzimi racional i ujit;
- Inspektimi për dëmtimin e sipërfaqës publike;
- Inspektime nga fusha e mbrojtjes së mjedisit;
- Inspektime për gjendjen e pastërtisë në hapësirat publike;
- Kontrolla për vendosje konform ligjeve për mbishkrimet, panot dhe tabelat reklamuese;
- Inspektime tjera nga fusha e përgjegjësisë.

#### 2.1.1. Pasqyra tabelare:

Përshkrimi i aktiviteteve	Numër
Inspektime në terren me procesverbal	202
Riinspektim	900
Aktvendime për eliminim të parregullsive	/
Kërkesa zyrtare të trajtuara	/
Vendime për ekzekutimin e akteve administrative	3
Gjoha Administrative	4

### 2.2. Sektori i Ndërtimit

- Kontrolla inspektuese në parandalim të ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi i lejeve të ndërtimit dhe certifikatën përdorimit;
- Mbikëqyrja e ndërtimeve me leje ndërtimore;
- Rrënimi i ndërtimeve pa leje;
- Inspektimi dhe lëshimi i certifikat të përdorimit;
- Mbikëqyrja e objekteve të vjetra;

#### 2.2.1. Pasqyra tabelare

Nr.	Përshkrimi i aktiviteteve – veprime të ndërmarra	2024
1.	Inspektime në teren	1000
2.	Vizita dhe kontakte pune	200
3.	Inspektime me procesverbal	40
5.	Aktvendime për ndërprerje të ndërtimeve	/
6.	Aktvendime për rrënim	/
7.	Konzervime të objekteve të ndërtimit	/
8.	Gjoha Administrative dhe Mandatore	1
9.	Inicime të procedurave kundërvajtëse	3
10.	Kallëzime penale	3
11.	Ankesa të tej shqyrtuara gjatë vitit 2024	/
12.	Inspektime të objekteve banesore-afariste	30
13.	Inspektime të objekteve banesore individuale	30
14.	Inspektime të objekteve afariste – shumëbanesore	200
15.	Mbikëqyrja e lejeve ndërtimore të lëshuara nga DPU	30
16.	Mbikëqyrja e lejeve-përligjimeve të lëshuara nga DSHPJ	30
17.	Ankesa të trajtuara	/
18.	Kërkesa zyrtare të trajtuara	/
19.	Lëndë në procedurë	14
20.	Lëndë të përmbaresh	/

### 3. PËRMBLEDHJE E RAPORTIT TË PUNËS

Raporti i përmbledhur i punës së Drejtorisë së Inspeksionit për vitin 2024, është raporti i përmbledhur i punës i të gjithë sektorëve në drejtori dhe përfshin aktivitetet, veprimet dhe masat e inspektoratit komunal në zbatimin të ligjit, akteve nënligjore dhe planit të punës.

Në ushtrimin e funksionit dhe autorizimeve, bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore, Drejtoria e Inspeksionit konsideron se ka përmbushur Planin Vjetor të Punës të vitit 2024 për periudhën Janar-Dhjetor.

#### 3.1. Pasqyra tabelare

Nr.	Aktivitetet, masa dhe veprimet	Njësia
1.	Inspektime me procesverbal	205
2.	Riinspektime	850
3.	Vizita dhe kontakte pune	600
4.	Aktvendime për eliminim të parregullsive	/
5.	Aktvendim për marrjen e pëlqimit për Taxi	/
6.	Aktvendime	3
7.	Vendime për ekzekutimin e akteve administrative	3
8.	Biznese të regjistruara për herë të parë	/
9.	Shuma e inkasuar nga gjobat me Rregullore Komunale	2,500.00 Euro
10.	Mjetet e inkasuara nga Komisioni për kushte minimale	/
11.	Vlera e produkteve të ndaluara	/
12.	Aplikime për pëlqime minimale-teknike	/
13.	Produktet të ndaluara nga shitja	/
14.	Vlera e mallrave të asgjësuar	/
15.	Kërkesa zyrtare	/
16.	Ankesa	/
17.	Gjobë administrative dhe mandatore	4
18.	Mbyllje e lokalit	/
19.	Vlera nga gjobat	2,500.00 Euro
20.	Shuma të inkasuara	2,500.00 Euro
21.	Shuma të pa inkasuara në procedurë	/
22.	Vlera e mallit të asgjësuar nga shitja	/
23.	Inspektime të objekteve banesore-afariste	16
24.	Inspektime të objekteve banesore individuale	34
25.	Inspektime të objekteve afariste shumë banesore	600
26.	Kallëzime penale	/
27.	Lëndë në procedura tjera gjyqësore	/
28.	Leje për ndërtim nga DSHPI	/
29.	Leje Ndërtimore nga DPU	/
30.	Aktivizimi për rënie	/
31.	Lëndë në procedurë	14
32.	Lëndë të përmbuaruara	/

#### PËRFUNDIM

Raporti vjetor i Punës i Drejtorisë së Inspeksionit është dokument i rëndësishëm së veçantë ngase ofron informacione të rëndësishme mbi punën, aktivitetin dhe angazhimin e kësaj drejtorie në zbatimin të ligjit, mbrojtje të rendit komunal si dhe mbrojtjen e interesit legjitim të Komunës së Mitrovicës dhe qytetarëve të saj. Në kuadër të ushtrimit të funksionit dhe mandatit ligjor, Drejtoria e Inspeksionit ka hasur në një varg vështirësish, siç janë ato të natyrës njerëzore po ashtu edhe

teknike, të cilat janë tejkaluar me sukses, falë profesionalizimit dhe vullnetit të lartë të treguar nga menaxhmenti dhe stafi profesional i kësaj drejtorie.